

Dimitar Miti



NATA  
E  
BARDHË

tregime

SH-32

N1 85

Dhimitër  
Miti

rrallinjdhë

ARTIKULI A KUQJELIM

Nata e bardhë

Nata  
e  
bardhë

tregime



SHTËPIA BOTUESE  
«NAIM FRASHËRI»

## Nata e bardhë

Ndërsa përgatitja darkën për shokët dhe gdhendja një lugë me bilbil në dru panje, nga mendja nuk më hiqej një grindje që kishim bërrë ne me Stefon, brigadierin e blektorisë. E ç'nuk i bëra Stefos atë ditë. Më dukej se e kisha përpara dhe ia numëroja të gjitha. E pyesja dhe përgjigjesha kur më pyeste ai (të gjitha këto, të kuptohej, ndodhnin në mendjen time), dhe i lëshohesha përsëri me tërbim. Grindja e vërtetë me të kishte ndodhur pak ditë më parë. Ai kishte dhënë urdhër që ne të zbritnim dhentë poshtë në mes të nëntorit. E pleqëruam urdhrin e tij dhe vendosëm të mos zbritnim poshtë, sepse mali kishte ende bár të mirë. Kështu kursenim edhe hasëllët, që ndonjëherë na i mbillnin më pak nga ç'duhej. Pastaj vajti dava e gjatë, me letra dhe me zënka të tjera, po ne nuk lëshuam pe nga jona.. Kur lindën shqerrat e para, u ndez sherri më keq. Atëherë Stefoja dërgoi ur-

dhër tjetër me shkrim. Përgjigjen prej nesh nuk e donte me fjalë. Në atë letër ai kishte shkruar disa herë fjalën «pérndryshe» dhe dukej sheshit se po na kërcënonte. Braçja, kryebariu i kopesë sonë, na e lexoi me zë letrën e tij, po ne përsëri nuk lëshuam pe nga jona.

E pra, të gjithë grindjen me të unë e përsërita me mendjen time atë ditë, sikur ta kisha edhe atë vetë përparrë. Eh, Stefo, ia bëra pastaj i lodhur dhe lashë drurin e panjës mënjanë. M'u duk se bashkë me drurin e panjës lashë edhe zënkkën me Stefon.

Mali po ulte hijen poshtë, siç ul streha e kapelës hijen mbi fytyrë. Prita sa hija vajtî deri te një shenjë që e dinim ne dhe mbajta vesh. Kishin filluar të zbritnin dhentë. Dukej sikur nga mali nuk po zbriste një kope me dhen por ortek dëbore. Dëgjoja zbritjen e kopesë dhe kënaqesha me zhurmën e dashur, që e shkakton vetëm ajo. Eh, Stefo, ia bëra përsëri dhe psherëtiva thellë.

I hodha një krah dru zjarrit dhe lëviza pak. Këmbët po më mërdhinin si pér dëborë. Kopeja po futej në vathë, ndërsa Braçja me Llazin erdhën pranë zjarrit.

— Erdhët! — thashë sa pér të thënë diçka. Braçja shtrëngoi buzët dhe vështrimin ia ngulli zjarrit. Pastaj uli kokën mbi gjoks dhe mori frymë thellë.

— Erdhëm, sikur do t'i jepnim gji fëmijës, — tha pas pak, sikur bashkë me fjalët shkulte nga gjoksi copa mushkërie e brinjësh. Vështrimin ia hoqi zjarrit dhe ia nguli si gozhdë Llazit. M'u kujtua përsëri Stefoja. Më urdhrin e tij pér të zbritur poshtë ishte dakord vetëm Lla-

zi. Mendova se do ta kishin kujtuar atë punë gjatë ditës dhe do të ishin grindur.

— Mirë erdhët? Tani u bë natë... vend i thepisur, — fola shpejt e shpejt.

Ai ngriti vështrimin nga unë. Dukej se ishte tërë inat.

— M'i hëngri veshët ky, — tha, sikur unë të mos kisha folur fare. — «Hajde që hajde të shkojmë, thoshte: Hajde se do të na zërë dëbora në mal.» Po... kam edhe unë faj. I thashë se sonte mund të bjerë dëborë dhe këtij iu cingërisën nervat. Dhentë ranë në bar të mirë. Pse ta hajë dëbora kullotën? Hëna tani del. Dita është e vogël. Nata e ftohtë. Ca e fillojnë kullotën vonë se mëngjesi është më brymë, ca i sjellim shpejt dhe «na rroftë motra e burrit» pastaj. — I hodhi edhe një vështrim Llazit dhe heshti papritur.

Nuk kisha ç'thosha dhe, për të mos ngjalitur ndonjë sherr të ri, zgjodha të udhës të shkoja në vathë. Dhe shkova. Menda shqerrat, zura mirë disa shtigje dhe u ktheva te zjarri. Ata i gjeta të dy kokulur.

— Shkojmë nesër dhe e hamë bashkë barin. — thashë, pa qenë i sigurt se thashë diçka të pjekur.

**Braçja qeshi. Qeshi siç qesh vetëm ai: me kur-sim** të madh, se mos i harxhohen buzët, dhëmbët...

— Nesër, the?! — më pyeti, por nuk priti përgjigje. — Thuaje edhe një herë, të bëhen dy. Nesër e gjen nuse Begezen, lum Braçja? — Fytyra i mori një pamje të atillë, thuajse në të ishin strehuar përkohësisht ngrica, stuhi, erëra.

Pashë Llazin që u drodh.

— I thashë që të shkontë, — murmuriti ai, si-kur t'i fliste vetes.

— Të hamë njëherë, pa shohim e bëjmë, — thashë për t'i qetësuar disi. U ngrita, mora torbat dhe nxora perj tyre taset prej plastike. Pa-staj nxora tri kokrra qepë dhe ua lëshova përpara.

— Për tri-katër orë arrinim poshtë, — vazhdoi Llazi. Flaka e zjarrit luante me hijen e hundës së tij, duke ia çuar herë nga balli. herë nga veshët dhe herë nga faqet.

— Mbushja mirë këtij, se u lodh sot, — tha Braçja, — sa për ato që thotë, mos ia vër re. Aguridhe është dhe do të mësohet.

Darkën e hëngrëm fare pa folur. Gjatë kë-saj kohe Braçja vështroi disa herë qiellin, kur nuk e shihte Llazi.

U ngrita për të larë taset. Diku, pas shpinës së Llazit, ngrita edhe unë vështrimin nga qielli. Ýjet ishin ndezur shumë. Kur yjet ndizen në qiell, prishet moti. Këtë na e kishte treguar je-ta shumëvjeçare në mal.

— Mos i laj enët, — urdhëroi Braçja. — Sonte do të gdihemi te vatha. Merr nja dy urë, se do të ndezim zjarr. Dhentë duhen trembur me urë gjatë natës për të mos i mbuluar dë-bora.

— Të kishim shkuar, — hungëroi Llazi.

Unë qëndroja në këmbë, me tase në dorë, si ata kamerierët që kanë ngatërruar tavolinën ose llojin e porosissë. Frynte erë e ftohtë dhe e mprehtë, si teh thike. Shenja të sakta dëbore.

— Lëmë Llazin këtu, — thashë.

Braçja më vështroi ashpër.

— Nuk i dashke të mirën, o Fotaq, — vë-rejti. — Sidoqoftë, jam unë me ju apo nuk jam,

mos e bëj tjetër herë këtë. Ndryshe është puna me një pjesëtar të familjes sate, megjithëse edhe për atë nuk ta fal shoqëria. E merr më qafë tjetrin. Kështu, Fotaq. Jeta çahet me gjoks, — tha këto fjalë, rrëmbeu dy urë zjarri dhe u nis për te vatha.

I lashë ta set në sofatin e sajuar me drurë. Futa nën sqetull transistorin, rrëmbeva edhe dy urë zjarri dhe eca pas tij. Pas meje vinte Llazi, i futur i gjithi nën gunë. Ishte i ri, rreth 22-23 vjeç dhe nuk ishte mësuar me malin.

Zjarrin e ndezëm shpejt te dera e vathës. Drutë e shkarpat i kishët tharë cikna dhe ato kërcitnin sikur shpinin kockat. Zjarri filloi me njëherë të dërgonte shkëndija në qiell, si shkesë për t'i mbushur mendjen hënës, por ajo bënte naze, fshihej herë pas ndonjë druri ahu, herë pas ndonjë majëze mali.

Një vrundull ere, si ato që ngrenë pluhur në mes të rrugës, përzjeu flakët e zjarrit dhe tra-zoi hirin. Llazi vështronte andej i zhytur në mendime.

— Të zihet shkalla e grykës dhe hajde zbrit, po ta mbajti, — tha ai, pikërisht atëherë, kur unë mendoja se nuk do të fliste më gjatë asaj nate.

— Kam frikën e hasëllit, — tha me merak Braçja, pa ua vënë veshin fjalëve të Llazit. — Ata të kryesisë raportojnë ndonjëherë në komitet sikur i kanë mbjellë hasëllët, por... ku i dihet ju kujtohet si ndodhi vjet? Për të qenë brenda me grurin, hëngrën tokë nga hasëllët.

— Nuk ma merr mendja ta kenë bërë prapë atë proçkë, — thashë i pasigurt. — Hëngrën dru njëherë dhe...

— Bëmë gabim që nuk u qëndruam vetë të koka.

— Iku ajo punë, o Braçë!

Ai mori orën nga xhepi dhe ia ktheu fu-shën nga flaka e zjarrit.

— Hape radion, — tha pastaj.

Radioja në fillim lëshoi disa vërvëllima, si ato të karkalecave të natës gjatë muajve të verës. Pastaj u krijua përshtypja sikur në të u përmbyssën vagonë me hekurishte, derisa më nё fund, pas çudirash të shumta, u dëgjua zëri i folëses sonë. Po jepeshin lajmet. Thoshte se nё shumë ndërmarrje kishin plotësuar planet e njëmbëdhjetë muajve. Disa ndërmarrje e kishin mbyllur planin e gjithë vitit.

— Ne jemi mirë me planin. — tha Braçja, sikur nё lajmet e Radio-Tiranës të ishte një bo-shllék, të cilin duhej ta mbushte vetëm ai.

Pastaj radioja bëri disa herë piu-piu, u duk sikur u rrëzuan përsëri vagonë të tjerë me hekurishte të vjetra dhe u qetësua papritur. Pas pak u dëgjua një zë burri. Ai foli për luftën midis Iranit dhe Irakut, për ndërrhyrje të super-fuqive (kokën të hanë, tha Braçja këtë çast). nё punët e brendshme të vendeve të tjera, për luftime të ashpra nё Afganistan e Salvador, dhe për parashikimet gjeniale të Enver Hoxhës, të cilat po vërtetohen nё Gjirin Persik, nё Lindjen e Mesme, nё Amerikën Latine, nё Evropën plakë e deri nё Ballkan.

— Ç'bëhet, o, ç'bëhet! — ia bëri Braçja, duke vështruar nga Llazi, me fytyrën tërë rrudha, sikur atë çast t'i ishin shkëputur njëherësh nga trupi mëlcia e zezë, zemra, mushkëria. — Dhe nё kemi frikë nga dëbora, — përfundoi, duke lëvizur mbi të ndenjura.

Kur radioja filloi tē fliste pér ngritje çmimesh, zhytje nē borxhé e krizë tē q̄isa vendeve, zéri i folësit humbi pak, u duk sikur u ndesh me vagonët, që rifilluan rrokullisjen, derisa u dëgjua disi kthjellët një zë i huaj, që thoshte shpesh «viç-viç», dhe Braçja tha tē mbyllej radioja.

— E morëm vesh. — shtoi me duf, — kot e kanë. Ti, Fotaq, do tē çohesh pas meje pér tē trembur dhentë. Llazi do tē çohet i treti. Hajt, mbështetuni, — tha pastaj e u mbështoll me gunë.

Nuk dija sa orë natë kishin kaluar. Këmbët po më mërdhînin. Më dukej sikur fytyrën ma ftohnin me akull dhe mbi sy më verbonin me dritë tē fortë. Në një çast u ngrita rrëmbimthi. Guna ishte rënduar. Sytë mezi i hapa. Kur qerpikët ishin larguar pak nga njëri-tjetri, m'u përplas në sy një masë e madhe drite. Pas shpinës sime kërcitnin urët në zjarr. Braçja nuk ishte pranë zjarrit. Pér një çast m'u duk sikur isha vërtet në ëndërr e po habitesha me veten, se pse po plakesha në mal e s'duhej tē më ndodhët ashtu. Dikur, pas brinjave, u dëgjua një rrëshqitje dhe ktheva kokën andej. Braçja po kthehej nga vatha me dy urë zjarri në duar.

— Shpejt u ngrite, — vërejti sapo u afrua.

— Mërdhiva, — thashë dhe u drodha pak, sikur ai nuk më besonte më fjalë. Iu afrova zjarrit.

— Të mbulova nja dy herë, po ti zbuloheshe prapë. Po me Stefon ç'dreqin kishe?! Ú hëngre goxha me tē. Lëre, dreqin, në punë tē vet. Kjo e uruar filloi menjëherë dhe shtroi si e pangopur, sikur do t'i shkonte mali dhe do t'i mbetej merak.

— Reeth nesh zbritnin nga qelli me mijëra flutura. Disa prej tyre binin mbi zjarr, tē ujëzuara.

— Si me inat e ka marrë, o Braç!

— Ka qëndruar në pemë, — tha ai. — Do tē bjerë tërë natën.

Llazi foli në gjumë dhe shtriu këmbët. Njëra iu fut në prush. Braçja ia largoi me kujdes dhe ia mbuloi me gunë.

— U lodh, — tha për tē. — Nuk është djalë i keq, vetëm ka ca frikë, por do t'i shkojë dhe ajo!

— Ç'bëjnë shqerrat? — e pyeta.

— Aty i kam, mbuluar me gunë, — tha ai dhe ndehu dorën përpara. Zëri i doli çuditërisht i butë.

— Fli ti tani, se i tremb unë dhentë, — iu luta.

Ai më vështroi një copë herë që poshtë vetullave tē varura mbi sy.

— U mbështeta nja dy orë. Me copa. Tani m'u arratis gjumi, — tha.

Heshtëm një copë herë. Flokët e dëborës binin duke bërë një zhurmë shumë tē lehtë, sa mezi dëgjohej. Žjarri hante me pangopësi tē çuditshme drutë që i kishte hedhur Braçja. Llazi foli përsëri në gjumë. Braçja më vështroi në sy.

— Eshtë i njomë, — thashë gati kot.

Ashtu kemi qenë tē gjithë, — vërejti. Pastaj hodhi gunën pas shpine dhe u ngrit, sikur donte tē pyeste edhe dhentë c'mendim kishin për Llazin. Po nuk u largua. Nën flakërimën e zjarrit pa orën. Pastaj shtrëngoi buzët dhe futi orën në xhep.

U ngrit Llazi.

— Auu! — ia bëri, sapo pa dëborën.

— Dëborë është, — i tha·me nënkuptim Braçja.

Elazi rrrotulloi vështrimin gjithandej dhe rrudhi buzët.

— Thashë të shkonim që dje, — tha, ndërsa mbështillte më mirë supet me gunë.

— Mërdhive? — i thashë.

— Edhe kjo na duhej, — tha ai, sikur unë të kërkoja prej tij pikërisht ato fjalë.

Mora dy urë zjarri dhe shkova në vathë. I lëviza në terr urët, sikur luftoja me shpatë. Dhentë u trembën dhe u rrrotulluan disa herë nëpër vathë. Nga kurrizi u binte copa-copa dëbora e bëutë. Poshtë në shtroje ajo u pëershesh, u përzie me pleh.

U ktheva te zjarri.

— E? — ia bëri Braçja.

— Mirë janë, — thashë dhe u ula.

Hëna vështroi me njërin sy nga një e çarë e reve. Nata u trondit pak, u shpërnda. Mbi pemë zbardhte akulli.

— Kushëdi ç'bën mushka! — thashë befas.

— Hëm! — ia bëri Braçja, — e harruam, të gjorën.

— E qeverisa vetë. I hodha sa për të ngrënë tërë natën, por e kam hallin te Gropa e Hithrave. Do të ketë mbledhur shumë dëborë.

— Atë punë ka, o Fotaq, le të mbledhë.

Braçja fshihte përbrenda vetes një qetësi të çuditshme thua jse nuk bëhej merak për asgjë. Çdo punë e peshonte mirë dhe, po të merrte një vendim ai, shumë rrallë mund të gabonte. Por edhe atëherë dinte si të vepronë. Këto prova ia kishte kërkuar mali dhe ai ia kishte dhënë.

— Edhe kjo na duhej! — përsëriti Llazi.

Heshtje. Heshtje dhe natë. Natë e bardhë.

Në qiell höna po na përgjonte. Drurët në faget e pjerrëta të malit shkundnin nga supet copa dëbore dhe akulli, që binin mbi tokë duke bërë «pup-pup», sikur uleshin zogj.

Braçja vështroi përsëri orën.

— Tre ora, — tha, — erdhi mëngjesi.

— Shkojmë në kasolle, — tha Llazi.

— Jo, — ia preu Braçja, — tani do të nisemi për poshtë. Sa të ecim pak ne, vjen ditë. Apo jo, Fotaq?

— Ashtu bëjmë!

I thamë Llazit të mblidhte plackat, të merrte shqerrat dhe të na priste te kasollja. Braçja do të shtynte dhentë përpara, kurse unë do të merrja mushkën.

Mushka shkrofëtinte në kasollen e saj. Ashtu bënte ajo sa herë ndiente të ftohtë. Shkova të hapja derën, po Xebi, që më kishte ndjekur pas, më pengoi. Pastaj lehu me kokën të kthyer poshtë, andej nga ngjiteshim malit në verë. Përgjova pak, se e kuptova që ai diçka donte të thoshte. Dëgjohej një zë i mbytur, që vinte si nga lugina. Dëbora thithte zërin dhe unë mendova se zëri duhej të ishte afër. Mushka më vështroi si e malluar, me njëfarë pikëllimi në sytë e lëngëzuar. Xebi i shkoi te këmbët dhe e përkëdheli me bisht. Ishin shokë të mirë të dy, sepse, sa herë kthehej mushka nga baxhoja, me Xebin rrinte. E tërhoqa mushkën drejt kasolles sonë, ku priste Llazi, por nuk munda të ecja as disa hapa, se dikush thirri nga mbrapa dhe qëndrova. Mushka shkrofëtiu fort. Lart lehën fort qentë e tjerë. Ishte një marrëveshje apo ndërlidhje pak e çuditshme ajo, por ne e njihnim mirë. Dëbora nuk e thithte dot të gjithë

zérin. Tepricat i përcillte te ne. Zéri u dëgjua fare afër.

Nën Gropën e Hithrave po ngjiteshin dy njerëz. Mezi i njoha. Ishte Jorgoja, shoku ynë, që kishte shkuar në shtëpi për hall dhe Stefoja, brigadier i blegtorisë. Qenkan të marrë, thashë me mend dhe prita.

U takuam. Ata duart i kishin më të ngrohta se të miat dhe gjoksi u lëshonte avull.

— Si janë bagëtia? — pyeti Stefoja.

— Mirë fare, — thashë.

— Bëtë gabim që nuk zbritët kur urdhërova unë, — vazhdoi ai. Sesi m'u duk atë çast. Si një lëmsh i zi, të cilin e kishte vjellë dikush nga gjiri i bardhë i dëborës.

— Të takohemi mirë njëherë, pastaj flasim për këto, o Stefo.

U ngjitëm lart.

Braçja me Llazin po na prisnin. U takuan edhe ata me të ardhurit. Vazhdonte të frynte thëllim si thikë. Hëna luante me retë lojën kufshehtas.

— Mbërtheni gjokset! — këshilloi Braçja.

U shkëputa pak e fillova të grisja në copa një thes liri. I lidha me to këmbët e mushkës dhe i thashë Llazit të ngarkonte në të plaçkat më të domosdoshme, kurse shqerrat t'i mbësh-tillte mirë dhe t'i vendoste në mes të samarit.

Braçja nxori nga kolibja jonë një nga bidonët e qumështit dhe një litar.

— Këtë litar lidhe me kapakun e bidonit. Bidonin do ta mbushës me gurë. Pastaj do ta têrheqësh pas vetes në rrugën që do të shkojmë. Unë me Llazin do të shtyjmë dhentë në ullukun që do të hapë bidoni. Mushkën do ta marrë

Jorgoja, — ndau detyrat shpejt e shpejt ai dhe vetë shkoi pas dhenve.

Veprova si më tha Braçja dhe eca përpara.

— Prit, Fotaq, mos u nis! — tha Stefoja me një zë që mua, s'di pse, m'u duk më i ftohtë se dëbora.

Ktheva kokën nga ai, si për t'u bindur më mirë për ato që tha dhe e vështrova me ngulm. M'u duk shumë i verdhë dhe buzët i dridhesin pak.

Iu afrua Braçja.

— Pse, korrik vjen, o Stefo, që të qëndrojmë sa të duash ti?! — i tha ashpër, por edhe me një fije durimi. Stefoja hoqi çantën nga krahët dhe e lëshoi mbi dëborë.

— Unë kam dhënë urdhër, shoku Braçë, që t'i zbritni dhentë që para tri javësh, — foli, duke iu ngatërruar fjalët nëpër buzë, ndërsa mundohej të zgjidhte rripat e çantës. — Ju ma keni thyer urdhrin.

— Për këtë na mbajte? — pyeti përsëri Braçja.

— Për... kë... të!

Braçja u kthye rrëmbimthi nga unë.

— Shko përpara! — më urdhëroi.

Stefoja e kishte zgjidhur ndërkaq çantën. Nxori prej andej një bllok dhe u ngrit. Para tij u dukën dy gropëza të zeza, të formuana nga gjunjët. Filloi të shfletonte vrullshëm bllokun. Diku e ndërpren shfletimin dhe e ngriti bllokun lart. Fytyra i ishte verdhur më shumë e buzët duke shkin sikur numëronin diçka.

— J j j... ja protokolli i i i ... mbajtur në mbledhjen e kryesisë, — tha me rrëmbim, duke i ngatërruar tingujt. — Ti, Braçë, nuk pyete

as kryesinë, që është kryesi, dhe as mua, që jam brigadier.

Mua po më kërcenin kacabunjtë. Braçja u kollit. Llazi godiste dëborën me majën e opin-gës. Qentë shtynin me kokë dhentë. Jorgoja diçka po bënte në koliben tonë.

— E shoh që i ke zënë qetë keq, o shoku brigadier, — shfryu Braçja dhe shtrëngoi dhentë për rrugë.

— Budallallëqe, o Stefo, — tha Jorgoja, që sapo doli nga kolibja.

Stefoja tundi bllokun në ajër.

— Budallallëqe i quani ju këto! E paçka, zotëria juaj, por i thonë kryesi kësaj që ka fir-mosur këtu në protokoll, me dorën e saj, fjalët e mia dhe vendimin e saj. Kështu?!

— Kështu! — përqeshi i nxehur Braçja. — Ashtu ia thatë ju problemin kryesisë, dhe mua, si kryebari, nuk më përfillët fare.

— Nuk dua llafe! — e ndërpree Stefoja. — Do t'i numëroj unë dhentë një për një. Që tani.

— Ne kemi ecur përpara, zoti brigadier. Na fal që nuk të kemi njoftuar. Tani i numërojmë dy nga dy dhentë, — u tall Braçja.

Ne qeshëm me zë. Jorgoja pështyu mbi dëborë.

— Mirë, dy nga dy, — u huluat Stefoja. — Do t'i numëroj vetë. Kështu! Me protokoll në dorë. Që tani! Sidomos shqerrat. Që tani!...

— Që tani! — përqeshi përsëri Braçja, duke u kthyer nga unë.

Brigadieri e vështroi sikur matej ta hante.

— Të lutem, shoku Braçë, mos më përqesh! — u qa.

— Që tani nisi dhentë, Fotaq! Dëborë nuk po binte më; Lindja po zbardhej.

Thëllimi po mprihte tehun. Qentë, lehnin ash-për. Unë eca përpara tyre, duke têrhequr me litar ibidonin e mbushur me gurë.

— Të...të u... urdhëroj, shoku Braçë, unë jam b...

Jorgoja e kapi Stefon nga krahët dhe ai nuk mundi ta mbaronte mendimin.

— Të dija të pjekur, — i tha qetë.

— Ndaloni kopenë!

Kisha ecur një copë rrugë. Pas meje, shtruar-shtruar, vinte bidoni. Pas tij vinin dhentë, varg, me gjysmën e trupit në ulluk'. Para kasolles sonë bëhej ende zhurmë.

— Ja, ç'bëni ju, shoku Braçë, — thoshte Stefoja. — Kërkoni thasë për gjëra të tjera dhe i grisni për të shpëtar lëkurën tuaj. Pastaj kërkoni t'ju firmos unë procesverbalet. Jo u gris këtu, jo e hëngri kripa, jo e dogji djersa, thoni në fund. Dhe unë budallai firmos. Më keni gjetur leshko. Tani s'ka! Do t'i numërojmë të gjitha: dhentë, shqerrat...

— Yjet, — e ndërpreu Braçja.

— Çdo gjë që keni marrë me firmë. Do të bëjmë procesverbal dhe...

— Po një çikë shpejt, se largohën...

— Që tani!

Qëndrova në vend dhe vështrova andej. Vinte zëri i Braçës:

— Në qoftë se ke ardhur për të më zënë në faj sepse të theva urdhrin dhe të kam kritikuar për të metat që ke, thuaje troç, o Stefo. Për çdo gjë që lidhet me kopenë përgjigjeni ne. Tani e pamë ne të udhës për të zbri-tur, tani do të zbresim. Pastaj... të kemi lënë dhe ty pak kohë për të irregulluar kasollet e dimërimit të bagëtive dhe kolibet tona, që deri

para një jave nuk i kishe prekur e dorë. Tani mos na bjer më qafë. Atë bllokun të këshillloj ta mbash, se, helbete, hall insani, si i thonë, të duhet.

Pastaj u duk Stefoja, që ngriti bllokun lart.

— Jaa, — u dëgjua zëri i tij, — jaa ku i ke të shënuara të gjitha. Këtu janë. Mos ki frikë. Ngordhi dhentë ti sikur i ke të babait. Grisi thasët ti. Thasët prej liri. Jaaa, — ia bëri më në fund dhe në faqen e malit, nëpër trungjet e drurëve e rrëzë gurëve përplaseshin a-të e tij, si copa klithmash që kërkonin më kot njëra-tjetrën.

I lashë a-të e Stefos të bënin ç'të donin dhe eca përpara, rrugës. Trungjet e prera ishin mbushur me dëborë dhe nuk dukej asnjë shenjë tjetër për drejtim. Qëndrova një çast, pa ditur ç'të bëja. Pastaj vështrova nga Braçja për t'i kërkuar ndonjë mendim. Ai po ndiqte midis dhenve deshtë më të fortë dhe, pasi kapi dy prej tyre, m'i solli mua.

— Lësho këta përpara, — tha. — Këta e mbajnë mend mirë rrugën dhe janë të fortë.

Deshtë nuhatën pak çaste dëborën përpara këmbëve të tyre. Pastaj më vështruan mua, si për të marrë leje, dhe filluan ecjen me galop. Në vazhdën e përsleshur të tyre ecja unë. Pas meje vinin dhentë. Ato janë të vetmet kafshë që nuk ndahen nga njëra-tjetra.

I thirra Llazit. Desha ta kisha afër më ato çaste dhe t'i flisja për shumë gjëra. Për gjëra që lidheshin me delen. Netve të gjata të vjeshtës, pranë zjarrit, kishim folur shumë, por ato nuk ishin gjë para atyre që më erdhën në mend ato minuta. I thirra përsëri, por ai nuk m'u përgjigj. Në vend të tij u përgjigj Braçja.

— E vrou dëbora, — tha ai me pak zë, duke

kthyer shpinën nga unë. Poshtë gunës vare-shin dy këmbë. Gjë tjetër nuk dukej.

— Ee?! — ia bëra, sepse nuk kuptova gjë.

— Ia vrua sytë dëbora, — shpjegoi ai, — Nuk do që të shohë dëborë. Mos i thirr sa të dalim në dhé të zi.

Një ndjenjë e çuditshme më kllapoi trupin dhe para syve më doli vetja, në moshën e Llazit, në mes të dëborës, duke m'u marrë mendtë prej bardhësisë. Po tani... Tani, fola me mend dhe sesi më erdhi. Ula padashur kokën. Nuk fola.

— E, mo, se do të mësohet, — tha Bracja, ndërsa rregulloi më mirë trupin e Llazit në kurrizin e vet.

Para nesh kaloi një shtëllungë e madhe mje-gulle, si një copë natë, e trembur nga rrrezet e diellit, që bëheshin gati të dilnin nga malet tutje, tutje. Pasi iku ajo, gjithçka zbardhi si në ditë me diell. Unë atëherë munda të kuptoja se qerpikët po më rëndonin nga pagjumësia, se këmbët i kisha krejt të lagura nga ai marshim. Ashtu si unë ishte edhe Bracja, edhe Jorgoja, i cili kishte bërë tërë atë rrugë, që mezi bëhej në korrik. Ashtu ishte edhe Llazi, bariu më i ri te ne.

Stefoja ishte tjetër brumë,

## Dobësi

Punonjësja e shërbimit postar kishte dalë të dera, me dorën e djathtë të ngritur lart, duke lëvizur njëkohësisht edhe gishtat, si në rastet kur i thuhet dikujt të afrohet. Ajo kishte trup të shkurtër dhe dora e saj valëvitej sa po mbi kokat e njerëzve. Kë kërkonte në atë det të vogël njerëzish? Vendosa majën e gishtit tregues mbi gjoks. Mua më kérkon? Ajo tundi kokën. Unë isha përgjegjës i bibliotekës së shkollës, merrja shtypin dhe letra të ndryshme që vinin nga qendra.

— Ka një lajmërim për drejtorin, — tha ajo, pa iu afruar mirë.

I thashë me të qeshur se ajo duhej të priste t'i thosha «mirëmëngjes!», pastaj... Ajo më tha se unë isha më nge, se i bija fyellit gjithmonë në një vrimë, ndërsa vetë ishte e zënë me punë deri në grykë.

— Je më tepër nga ç'duhet e shkurtër, — i thashë përsëri me të qeshur, — pa të vijnë pu-

nët deri në grykë. Po të ishe pak më e gjatë, do të ishe e zënë me punë të paktën deri në gjoks.

— Paske llafe shumë sot ti! — tha ajo nervoze dhe lëshoi mbi rimeson e tavolinës një blok të ndarë në kolona. — Firmos këtu! Emër dhe mbiemër!

Unë shkrova në kolonën përkatëse emrin dhe mbiemrin, mora telegramin në dorë dhe lexova: «Hari Fotini të paraqitet sot në seksion». Nuk u besova syve. Ç'e donin Hari Fotinin? Për lëvizje? E pamundur. Ne nuk kishim veçse një muaj që kishim filluar punën. E lexova përsëri tekstin. Sytë nuk kishin gabuar aspak. Hari Fotini duhej të paraqitej atë ditë në seksion. Të paraqitet, përsërita me mend unë. Pse të përdorin pikërisht këtë fjalë, siç bën shpesh dega ushtarake? Apo pér t'i dhënë më shumë rëndësi lajmërimit? Ndoshta ai lajmërim kishte vërtet ndonjë rëndësi të veçantë dhe unë shprehesh fare kot armiqësisht pér fjalën «të paraqitet».

Dola në rrugë dhe nxitova.

Lajmërimin duhej t'ia jepja drejtorit. Vetëm ai kishte të drejtë ta lironte Hari Fotinin nga puna. Ia dhashë telegramin qetësisht.

Ai e mori atë dhe e hapi duke më vështruar në sy. Tallesh ti, apo... donin të thoshin sytë e tij. Këtë veprim drejtori filloi ta bënte pas një telegrami të ndërmarrjes së grumbullimit, që njoftonte pér mbledhjen e kërminjve. Në telegram shkruhej edhe leverdia ekonomike e tyre. Unë ia dhashë telegramin atë ditë në prani të gruas së tij. «Pse, edhe me kërminj merresh ti?!» e pyeti e habitur dhe me njëfarë krupe të shoqin ajo. Drejtori pati përshtypjen se atë telegram do ta kishim sajuar ne... Nejse, le të kthohemi te

ky lajmërim. E lexoi dy-tri herë. E lexonte dhe më shihte mua në fytyrë.

— Ç'bëjnë këta kështu, more, ç'bëjnë! — mërmëriti, pasi e lexoi për të katërtën herë me zë të ulët, sikur i trembej dikujt.

Unë nuk i thashë gjë, sepse nuk dija ç'kishin ndër mend të bënин shokët e seksionit me Hari Fotinin.

— Thuaji Harit të vijë më drejtori! — më tha, pasi u mendua pak. Palosi letrën më dysh dhe e futi në xhepin e këmishës, në krah të majtë.

I thashë Harit të shkonte më drejtori. Ai deshi të dinte përsë duhej të shkonte më drejtori.

— Unë sjell urdhrin e drejtorit, jo pse-në e këtij urdhri, — i thashë serioz dhe u ula më karrige.

Fytyra e tij bëri disa herë tualet me të kuq e me të bardhë brenda pak sekondave.

— Ti sesi i thua këto, mor jahu, — tha Hari dhe doli.

Unë nuk u shqetësova aspak për mënyrën e dhënies së urdhrit. Në fund të fundit, njerëz të ndryshëm i përcjellin urdhrat më mënyra të ndryshme.

Hari erdhi më sallën tonë pas pak, bashkë me drejtorin. Drejtori dukej i qetë, pa dallgë më fytyrë. Fytyra e Harit vazhdonte të vinte tualet me të kuq e me të bardhë. Ky diçka duhet të dijë, thashë me mend i sigurt.

Drejtori qëndroi përpara orarit të varur më mur.

— Orët e Harit do t'i bëjmë ne sot, — tha ai dhe shpejt e shpejt bëri orarin e ri.

Hari doli nga salla pas gjysmë ore dhe erdhi përsëri të nesërmën mëngjes me një makinë rasti. Ishte i qeshur. Ishim të gjithë më sallën tonë. Edhe drejtori. Hari nuk priti ta pyesnim

për se e kishin thirrur në seksion. Pasi tha «mirëmëngjesi!», nxori nga xhepi një copë letër të palosur. E shpalosi ngadalë dhe ia dha drejtorit. Ky filloi ta lexonte. Ne shikonim kureshtarë fytyrën e tij. Ajo u trazua pak. Ehe, ia bëra unë me mend, pa ditur mirë pse. Fytyra e drejtorit u trazua më tepër. Në fillim lëvizi buza e poshtme. E dyta lëvizi hunda. Në fund u puqën vetullat, sikur donin t'i thoshin diçka të fshehtë njëra-tjetrës.

— Këta nuk janë në vete! — tha drejtori, pa iu drejtar kujt. Vështroi nga Tomi. Fytyra e Tomit u skuq. E hëngri Tomi, thashë me mend.

— Të kërkojnë ty në sekcion, — i tha Tomit dhe i ndehu letrën.

— C’ma jep! — ia bëri Tomi dhe e shtyu letrën me dorë.

Drejtori qëndroi përsëri përparrorarit të vaxur në mur. Pasi bëri disa shigjeta të kuqe, me kokë lart e me kokë poshtë, tha se orët e Tomit do t'i bënim ne atë ditë.

Tomi u nis pas dhjetë minutash dhe erdhë të nesërmen në mëngjes, me autobusin e linjës. Hari nuk na kishte thënë, gjatë asaj kohë, se si qëndronte puna. Ai bisedoi disa minutë me drejtorin. Pas bisedës me të, Hari u bë i heshtur. Gjatë pushimeve të shkurtra lëvizte midis gishtave një laps të kuq, ndërsa vështrimin e ngulte diku, në një pikë, mbi një dollap të madh. Hari duhet të ketë diçka, thosha me mend. Isha vërtet i sigurt.

Tomi i dha drejtorit një copë letër të shkruar, afërsisht si letra që i dha Hari një ditë më parë. Ne përsëri vështruam drejtorin në fytyrë, si një ditë më parë. Drejtori e lexoi disa herë letrën. Fytyra iu tkurr é iu lëshua disa

herë. E palosi letrën dhe ia dha Harit. Hari ngriu në çast.

E hëngri Hari, mendova unë.

— Ata nuk janë, me gjithë mend, në vete! — tha nervoz drejtori. Letrën vazhdonte ta mbante të ndehur para fytyrés së Harit. Ky luante me laps. Ti tallesh, dukej sikur thoshte e gjithë fytyra e tij.

— Është për ty! — i tha Harit drejtori.

— Unë u sqarova një herë me ta, — tha ai me zë.

Drejtori qeshi.

— Mua nuk më lejohet të bëj shpifje, — tha qetë-qetë.

Dhe vërtet drejtorit nuk i lejohej të bënte shpifje.

Hari e mori letrën. E lexoi. E lexoi ngadalë. E lexoi përsëri. Më ngadalë këtë radhë. E lexonte dhe shtrëngonte buzët. Fytyra i bënte tu-alet. Herë të kuq, herë të bardhë. E futi letrën në xhepin e pantallonave dhe doli. Doli si hije. Ai duhet të dijë patjetër diçka, por na e mban fshehur, arsyetova me mend. Këtë dyshim ua thashë shokëve. Ata thanë se nuk dihej gjë e saktë. Thanë, gjithashtu, se nuk është mirë të konkludosh pa ditur si është puna. Mua nuk më pëlqeu përgjigjja e tyre, sidomos fjala «të konkludosh».

Drejtori këtë herë nuk vajti tek orari, por në telefon. U kthye pas pak që andej. Nëpër duar lëvizte një tufë me çelësa. Dukej nervoz.

— Thuajuni shokëve të mblidhen pak, — më tha mua.

Unë u thashë shokëve të mblidheshin pak.

Drejtori mori frysë thellë. Kisha kuptuar se, sa herë drejtori ynë merrte frysë thellë, do të kishte patjetër diçka me rëndësi. Me rëndësi të

madhe, të dorës së parë. Na i shpjegoi të gjitha. Ja si qëndronte puna:

Ne ishim kolektiv i një shkolle tetëvjeçare. Seksioni kishte urdhëruar në fillim të viti shkollor që të hapej edhe shkolla e mesme bujqësore pa shkëputje nga puna. Kishte filluar puna me vitin e parë të saj në të njëjtën ndërtesë. Mbi këtë plan ishte emëruar edhe kuadri. Kuadrin e përbënim ne, mësuesit e shkollës dhe disa specialistë të kooperativës. Pas një muaji pune, na i kishte vajtur mendja seksionit te njëra nga pikat e rregullores së Ministrisë së Arsimit, e cila ndalonte hapjen e shkollave të mesme pa shkëputje nga puna në ato vende ku ishte e pamundur hapja e tyre edhe për nxënës me shkëputje nga puna. Kështu, shkolla e mesme pa shkëputje nga puna do të mbollej. Rrjedhimisht, do të shkurttohej një vend pune. Kuadri i hequr nga shkolla jonë do të shkonte në një shkollë tjetër, larg qytetit. Hari kishte paraqitur raport mjekësor për paaftësi dhe erdhi përsëri në shkollën tonë. Edhe Tomi kishte paraqitur raport për paaftësi të njëjtë dhe erdhi përsëri në shkollën tonë. Raporti i Tomit duhej të ishte më i fortë se raporti i Harrit. Kështu arsyetonim ne. Dhe kështu duhej të ishte vërtet. Por doli që nuk ishte tamam kështu, derisa Hari erdhi përsëri dhe iku Tomi. Hari dhe Tomi jepnin të njëtat lëndë, kimi, biologji, mësimet e punës dhe kishin në ngarkim bazën materiale.

Për bazën materiale, që ndodhej në dhomën e Hirë, nuk u fol fare, sepse Tomi iku urgjent në shkollën tjetër, ku lëndët e tij kishin mbetur mbrapa.

Hari ishte i qeshur.

Mirëpo nuk ishte e thënë që kjo gjendje të qëndronte përjetësisht e patrazuar. Thonë që, po

i zure derën së mirës ose së keqes, të vjen nga dritarja. Kështu ndodhi edhe me Harin atëherë.

Një ditë erdhi në shkollë mjeku i zonës Merko Baçi. Ishte i shkurtër, i imët, me flokët gjysmë të rënë dhe gojën e kishte brisk. Gjeti rastin dhe u fut në dhomën e lirë.

— Ju mësuesit jeni budallenj, — tha ai. Kur mbaroi së shqiptuari fjalën «budallenj», vura re se ai i fryu pak faqet te nofullat dhe lëvizi supet, sikur donte të rregullonte njëkohësisht jakën e këmishës.

— Po të jemi ne mësuesit budallenj, — ia priti flakë për flakë Hari, — ju të tjerët duhet të jeni akoma më budallenj, sepse nga duart tonë keni dalë.

Mjeku Merko Baçi qeshi me të madhe, duke vënë pëllëmbën mbi bark. Ai ishte operuar një herë nga dhjamët dhe kishte frikë mos hante ndonjë thikë tjetër.

— Unë nuk e pata për të gjithë mësuesit, — tha, ndërsa qeshite, — por vetëm për ty, Hari, kështu që me një mësues budalla ne të tjerët nuk dalim budallenj, aq më tepër kur ti je mësues i lëndës bujqësore. — Ai qeshi përsëri me të madhë. Vështroi cep më cep dhomën e lirë (që nuk ishte e lirë), dhe na u lut që ta dëgjonom pak. Ne e dëgjuam me vëmendje. Ai tha se në atë dhomë luhej për mrekulli pingpong. — Vetëm se këto veglat, — shtoi ai, — duhet t'i vendosim diku që të mos na pengojnë.

Ky mendim i Merko Baçit na bëri të heshtnim. Të hapnim edhe sytë pak si tepër.

— E ç'më rri ashtu, do të vërtetosh se je budalla?! — i tha ai Harit dhe u shkri së qeshuri.

Hari kroi kokën.

— E di ti që nuk e ke keq? — tha tërë gjallëri.

Atë ditë unë mora vesh se Hari e paskësh shumë qejf lojën e pingpongut.

U ndezën diskutimet, u dhanë mendime për fushën, për rrjetën, për vendosjen e vleoglave. Hari ishte më i lumturi. Ai thoshte shpeshherë të do bëhej nami, do t'i mundtë të gjithë. Pa përjashtim. Edhe drejtorin.

Fusha e pingpongut u rregullua brenda javës.

Pas ngrënies së drekës, derisa mbaronte puhimi, Merko Baçin e gjeje në dhomën e lirë. Luante me atë mësues që nuk kishte mësim atë orë. Më shumë rastiste të luante me Harin. Hari fitonte shpesh dhe mburrej. Mjeku Merko Baçi nuk thoshte më se Hari ishte budalla. Ai ngulmonte të luante me të sa më shumë, sidomos pasditeve, derisa vinte urbani, me të cilin ata shkonin në shtëpi, në qytet. Hari thoshte shpesh se Merko Baçi hante dru prej tij, se ai në lojën e pingpongut ishte një hiç pa bisht, se ai kishte vetëm llafe, aspak nuhatje. I rruat që është mjek, shtonte Hari dhe jepte mendimin se duhej matur mirë para se të vizitoheshe tek ai. Hari vazhdonte të ishte i lumtur. E, pra, i lumtur. Merko Baçi bëhej xhind, por e ndrydhet inatin brenda vetes. Ai duhej të ishte shumë i fortë, derisa mbante tërë atë inat brenda vetes.

Çelësi i dhomës së lirë qëndronte midis tu-fës së çelësave të tjerë të klasave. Kush nuk ishte i zënë (por jo para orës dyimbëdhjetë), merrete çelësin, hapte derën dhe luante pingpong me kë të donte. Të tepërtit shihnin (po të donin) ata që luanin.

Hari vazhdonte të fitonte dhe të ishte i lumtur. Të krijohej përshtypja se Hari mund të vdis-

te menjëherë po të mos luante një ditë ping-pong.

Pas një muaji erdhi në shkollë Tomi. Ai kishte marrë nga drejtori ynë një telegram. Telegrami thoshte (këto telegramet kanë hije të rëndë) që të vinte në shkollë për të bërë inventarin e materialeve në ngarkim. Hari atë ditë u pezullua nga mësimdhënia. Do të merrte në ngarkim edhe materialet që kishte pasur në ngarkim Tomi.

Lumturia e Harit filloj të tronditej. Atë ditë Hari ishte pa qejf. Nuk fliste më për lojën e pingpongut. Mjeku Merko Baçi tha se ishte gati ta vizitonte Harin. Hari nuk i ktheu asnje përgjigje. Tërë ditën ai numëroi, bashkë me Tomin, kazmat, lopatat, gjithçka ishte në inventar. Tomi do t'i dorëzonte. Hari do t'i merrte.

Dorëzimi mbaroi vonë. U firmos procesverbali në prani të drejtorit. Hari dukej i kërrusur, thuhajse tërë ato hekurishte i mbante mbi shpinë.

Të nesërmen në orën dyshëmjetë e një cerek erdhi në sallën tonë Merko Baçi. Në sallë isha vetëm unë. Ai mori tufën me çelësa dhe diçka kërkoi në të. Kërkonte çelësin e dhomës së lirë. Nuk e gjeti. Më pyeti mua nëse dija gjë. I thashë se nuk dija gjë.

— Mbaroi inventari midis Harit dhe Tomit?

— pyeti pas një çastë të shkurtër heshtjeje.

— Mbaroi dje, — i thashë i sigurt.

Mjeku Merko Baçi përplasi pëllëmbën mbi tavolinë.

— Nuk e luan topi, Hari do ta ketë, — shfryu ai dhe filloj të lëvizte nëpër dhomë.

Gjatë pesë minutave që ndenji në sallë, më pyeti dhjetë herë nëse dija ku mund të ndodhej Hari. Unë i thashë dhjetë herë se nuk dija

gjë. Ai doli nga salla si një lëmsh ere. Kur mbeta vetëm, mendova për Harin. Vërtet, ku është Hari? Ai në këtë orë luante pingpong! Ç'kishte ndodhur me të? Kush e kishte marrë çelësin e dhomës së lirë? Dola nga salla pas gjysmë ore. Harin e takova para tregtores ushqimore.

— Të kërkonte Merko Baçi, — i thashë.

Hari më vështroi me inat. Unë i bëra shenjë të më thoshte pse rrinte ashtu, hundë e buzë. Ai bëri shenjë me dorë për të thënë: «Ç'më çan kokën dhe ti!» U tërroqa. Nuk doja në asnjë mënyrë t'i çaja kokën Harit.

U mor vesh që çelësin e dhomës së lirë e kishte marrë Hari. Ai e mbante vazhdimisht me vete. Dhoma e lirë rrinte mbyllur. Atje qëndronte fusha e pingpongut edhe veglat që mori ai në ngarkim. Pse nuk luante më pingpong Hari? Në qoftë se nuk donte të luante vetë, pse nuk linte të tjerët të luanin?

Për të nxehur Harin, Merko Baçi erdhi edhe disa herë për të luajtur pingpong. Hari nuk e jepte çelësin. Merko Baçi kërkonte të dinte prej tij pse para se të merrte në dorëzim materialet e jepte çelësin, ndërsa tani jo. Hari luante me laps dhe vështrimin e mbante të ngulur në një pikë mbi dollapin e madh.

— Kjo është dobësi! — i tha një ditë Harit Merko Baçi.

Hari e hoqi vështrimin nga dollapi dhe ia nguli Merkos.

— Më lër rehat! — iu lut me zë të prerë.

— Dëgjoni ç'thotë, more shokë? — na u drejtua neve Merko Baçi e përsëri u kthye nga ai.

— Ti nuk duhej ta kishe bërë këtë, Hari. Ose ta kishe bërë që në fillim, ose të mos e kishe

bërë fare. Kjo është dobësi, edhe në qoftë se nuk e them unë.

— Më lër rehat, të lutem!

— Veprimi yt, megjithatë, mbetet një dobësi. Kjo nuk varet nga unë. Ta thashë një herë.

Pas një jave fusha e pingpongut u prish. Pjesët e saj, si copa skeletesh të zbuluara nga gjermime arkeologjike, ndenjën jashtë, mbështetur pas murit, me një pamje të thellë tristimi e dëshire për t'u harruar. Po harresa nuk varej nga ne. Kujtimin e saj e ndez herë pas here mjeku Merko Baçi, i cili thotë shpesh se Hari nuk është i fortë vetëm në lojën e pingpongut, por është i fortë edhe në financë, sidomos kur është fjala për financën personale. Dhe, shton Markoja, të jesh i fortë në financë në këtë mënyrë, siç është Hari, është dobësi.

## Duke kërkuar derën

Fëmijët të hanë kokën, tha me mend për të disatën herë atë ditë Lilo Pata, ndërsa rriente shtrirë mbi divan, dy orë para se të filloente mbledhja e Frontit. E kishte quajtur atë shumë të rëndësishme, sidomos për djalin e tij të vogël. Çekani i rrihte më shumë tek ai djale, sepse vetëm ai i kishte mbetur në prodhim. Vajzat dhe djemtë e rritur i kishte rregulluar mirë me shkollë e me punë. Po «mjerë ai që është prind!».

Rinte shtrirë dhe sillte nëpër mend gjithçka kishte bërë për atë mbledhje. Gjithçka. Në radhë të parë kishte punuar, si i thonë fjalës, si derr. Ishte djersitur si ka. Edhe këpucë kishte grisur jashtë mase, sikur të ishte ndonjë maratonist profesionist. Madje ai kishte përshtypjen (dhe jo vetëm përshtypjen) se edhe dhëmbë i kishin rënë për hir të asaj mbledhjeje. Ai mbante mend mirë se dhëmbi i parë, më i miri, pikërisht gjatë atyre ecejakeve i kishte

rënë. E, pra, pér shkak të mungesës së atij dhëmbi, ai fliste sikur fërshëllente.

«Eh, mjerë kush është prind! Prind si unë!»

Psherëtiu thellë dhe iu bë se ishte në zyrë. Iu bë pastaj sikur iu afrua një mik i tij dhe i tha: «Lilo, ç'bën, e ke humbur fare, më keq se Xhaferri simiten! Je kuadër, Lilo, thirri mendjes! Bën goxha punë shteti dhe nuk bën një gjë të vogël pér familjen tënde!» Pastaj, pasi i iku ai, iu bë se iu afrua një mik tjetër, që i pëshpëriti në vesh: «Ti, Lilo, nuk e nxjerr dot qimen nga qulli. Ti, goxha kuadër, nuk lidh dot pantallonat e tua, ndërsa ne presim të rregullosh punë edhe pér ne. Ti.»

Djali im në prodhim?! pyeti veten, ndoshta pér të mijëtën herë dhe deshi të dinte ose të kuptonte se çfarë veprimesh kishte lënë pa bërë. Ja, para syve i doli karrigia. Mbi karrige shiltja. Ai ulur mbi të dyja, me bërryla mbi tavolinë. Mërzitja e ditëve të para deri aq, sa ishte bërë gati ta linte fare atë punë, atë zyrë dhe gjithçka lidhej me to.

— Ç'je budalla! — i kishte thënë një mik i tij dhe ai kishte hequr dorë nga ajo marrëzi. Puna i ishte futur në zemër. Ai u ishte futur në zemër të tjerëve. Në zyrë hynin e dilnin njerëz. Njerëz me halle. Liloja u buzëqeshte. U ndehte të dyja pëllëmbët dhe i takonte. Shpeshherë u mbështeste pëllëmbën mbi shpatulla, mbi sup. I ulte në karrigen përballë. U buzëqeshte përsëri. Pastaj:

— Po hë, ç'hall keni?

— Disha vjet rresht kjo pyetje.

Dhe i dëgjonte me vëmendje, duke i vështruar drejt në sy. Në sy ia thoshte edhe mendimet e veta. Nuk bënte gjë mbrapa krahëve ai.

Pikëllohej, dëshpërohej, se, në fund të fundit, njeri ishte, kishte fëmijë, shtëpi e katandi edhe vetë. Pasi e dëgjonte krejt hallin e tjetrit, lëvizte mbi karrige (edhe mbi shilte njëkohësisht). E dinte se lëvizjet e tilla ia merrnin për bezdi dhe ngriheshin. Ngrihej dhe Liloja, kur ngrihej tjetri, sidomos kur vinte nga masa. Patjetër duhej të ngrihej edhe ai. Ndërkaq kishte të gatshme përgjigjen:

— Sa të krijohet mundësia!

Disa vjet rresht e njëjtë përgjigje. As jo, as po.

Kërkesat me shkrim i shikonte më mirë, por edhe atyre u kthente të njëjtën përgjigje: «Sa të krijohet mundësia!» Kënaqej me këtë përgjigje. Përgjigje elegante, i kishte thënë ai i njo-huri, përgjigje që të ngroh, të mban me shpresë, por edhe nuk të nervozon.

Dhe: «guri në torbë».

Para syve i dolën një nga një, si në një paradë, shokët dhe miqtë. Përqafime, të puthura me lot. Lilo andej, Lilo këtej, dhe Lilon nuk e shihje kurrë pa xhaketë të shqepur nga fundi ose në bërryla, sado që ia qepte ose ia andronte gruaja cdo natë.

— C'pret akoma, filloi mbledhja! — dëgjoi Liloja zërin e gruas fare afër veshit dhe u tremb. Por e mori shpejt veten. Ia bëri disa herë: «Si, si?!» dhe u ngrit. — Fëmija të hanë kokën, — tha me zë, ndërsa futi këmbën e dajtëtë në këpucë. Vështroi gruan.

— Kumbulla ime! Sot do të bindesh plotësisht pér cilësitë e padiskutueshme të Lilo Patës, — tha me zë prej aktori, ndërsa po vishte edhe këpucën e majtë.

Në sallë ra papritur heshtja. Ulur në një-

rën nga karriget e lidhura varg, si ato të kinemave, ktheu kokëngjithandej, pér t'u bindur plotësisht pér fillimin e mbledhjes. E dëshiron te shumë atë fillim, sepse pas fillimit vinte fundi. Pas mbledhjes ai dinte vetë se ç'do të bënte.

Njerëzit ishin ulur të gjithë nëpër karrige, si ai. Të gjithë me shpinë në mbështetëse. Ndonjë, tek-tuk, mundohej të nxirrte fletë e laps nga xhepi i brendshëm ose i jashtëm i xhaketës. Ndonjë fshinte me kujdes hundët. Këto lëvizje i dukeshin Lilo Patës si veprime të bëra qëllimi shpëtueshëm pér të vonuar fillimin, rrjedhimisht edhe mbarimin e mbledhjes.

Gati ishte bërë nervoz, kur në tavolinat përballë, ku ishin ulur drejtuesit e mbledhjes, u shkëmbyen fjalë me zë të ulët. Njëri prej tyre rregulloi renditjen e fletëve. Lilo Pata e dinte se ato fletë ishin të raportit. Rreth tij do të vërtiteshin pyetjet dhe diskutimet, si bletët rreth mjaltit. Mjalti më i mirë ishte ai vetë. U mundua të gjente me mend se në cilën fletë ishte shkruar emri i tij dhe emri i të birit, të shoqëruar me fjali të shkurtra e me fjali të gjata, të rrethuar me mbiemra të nyjshëm e të panyjshëm, në të tria shkallët. Këto i dinte mirë, sepse ia kishte thënë një njeri i tij. I kishte thënë se i kishte parë vërtet në të papastër, në kopjen e parë, para se raporti të diskutohej para masës. Pra, kishte shtuar ai, ekziston mundësia (ekziston hataja, kishte thënë me mend Liloja) që, kur t'i kenë hedhur në të pastër, të kenë bërë ndonjë ndryshim, po sidoqoftë emri i tij do të ishte patjetër, i përmendur pér mirë, i rrethuar me mbiemra të hyjshëm, në të tria shkallët.

Po jetonte me këto përfytyrime dhe me fri-

kën që ngjall dyshimi, kur ai që do ta lexonte raportin kishte zënë vendin. Në moshë mesatare dhe i shkurtër, afërsisht në trupin e tij, ai fshihet pas kanës me ujë dhe Lilos i dukej sikur koka e tjetrit ishte brenda saj. Nga deformimet që krijonte uji, ajo dukej tmerësisht e shtrembër. Ç'e kanë caktuar këtë njeri me kokë të këtillë që t'i lexojë ato fjalë, mendoi me hidhërim. Po koka e futur në kanë u kollit, dolj prej andej, dhe atij iu largua shija e hidhur e përshtypjes së parë.

Burri përballë filloj të lexonte.

Drejtuesit e mbledhjes kishin mbërthyer duart përpara mbi tavolinë dhe vështronin diku, pa përcaktim. Kjo gjë nuk i pëlqeu aspak Lilo Patës. Ai donte që ata të vështronin atë. Ai miku i kishte thënë se shokët e ardhur nga komitetet ishin njohur me materialet e raportit kryesor të mbledhjes dhe, qishtë më madhështorja (pikërisht kështu i kishte thënë ai), ata ishin interesuar edhe për të. Vetëm të mos gërmojnë shumë përmua, kishte thënë me mend Liloja. Por ja, herdhi çasti që af të shqetësohet pak, sepse ata shokët e ardhur nga komitetet, nuk po vështronin fare nga ai. Të paktën të vështronte sekretari ose kryetari. Ah sikur... sikur..., psherëtiu dhe u përqendrua te folësi, duke menduar se ata nuk e bënин veten në sytë e të tjerrëve, po e kishin lënë njohjen nga afër, kur të dilnin nga mbledhja! Prite tani, tha pas pak me mend, kur të dalë emri, dhe i dukej se, sapo të ndodhët kjo, dikush do ta ngacmonte, duke i thënë me zili: «Lum ti, Lilo, lum ti!»

Numëronte me sy ëndërrimtarë fletët e rapportit, të cilat folësi i hiqte njérën pas tjetrës. Në fletën e katërt, i kishte thënë shoku, atje

ndodhen emrat tuaj. (Ah, kur nuk e pe edhe  
në kopjen e pastër! Ja, folësi filloj të lexonte  
faqen e katërt. Liloja ndjeu zagushi. Fytyra iu  
nxeh, ndërsa në gjoks, poshtë grykës, pati për-  
shtypjen se kapërceu diçka të ëmbël. (Në fund  
të fundit, a nuk lidhet çdo gjë me të ngrënët?)  
Filluan t'i gjëmonin veshët, por nuk u zemërua.  
Kështu i ndodhte sa herë lavdërohej nëpër mble-  
dhje. Ai ishte lavdëruar shumë herë, por vite  
më parë, kurse kohët e fundit ishin shtrënguar  
pak gjérat. Le që kot ta vriste mendjen për atë  
boshllëk. Ja, erdhi rasti të lavdërohem përsëri,  
pastaj di unë ç'të bëj, tha me mend dhe qeshi  
pak. Folësi i ishte afruar mesit të fletës së ka-  
tërt dhe ai ndjeu se trupi iu prushit i téri. Aaaty!  
ia bëri me tërë qenien e tij dhe u ngjesh më mirë  
në shpinën e karriges. Zhurma në veshët iu kthyte  
në kënaqësi. Dhe e dinte se një ndjesi të tillë  
ia shkaktonte vetëm dëgjimi i emrit të tij (i  
përmendur për mirë), në castet kur kishte shu-  
më nevojë për të. Humbi për një cast kontro-  
llin ndaj vetes, ferkoi gjoksin, mbylli sytë dhe  
deshi që nëpër veshë t'i vinin rrrotull, pa zhur-  
më, yetëm tingujt e emrit të tij, të Lilo Patës,  
të kuadrit të palodhur, të aktivistit të dalluar,  
që vë interesin e përgjithshëm mbi atë perso-  
nal. Dhe ai jetoi çaste të këndshme me këtë  
mrekulli, u kënaq, iu rrit besimi te shokët e  
miqtë që i bënë këtë nder, pavarësisht se di-  
kur kishte lënë përshtypje jo të mira. Njeriu  
është njeri. Ndryshon.

Folësi kishte kaluar më poshtë, por Lilo Pa-  
ta vazhdonte të mbante në mend e në veshë  
emrin e vet, të ndjekur ose të rrethuar nga  
tërë ata mbiemra. Ferkoi gjoksin përsëri dhe  
hapi sytë më shumë nga ç'duhej. Boll tan, tha

me mend, të gjitha që do të lexohen më poshtë janë formalitetë. Iu bë se nga pas ndjeu një ngacmim të lehtë, por nuk u kthyesh mbrapa. Nuk donte kurrsesi ta shihnin që s'e kishte vëmendjen te folësi, sidomos atëherë, kur mund të vështronin edhe shokët e ardhur nga komitetet. Përsëri pati përshtypjen se e ngacmuani nga mbrapa dhe lëvizi pak.

— Mos më pengo! — i foli dikush nga mbra-pa dhe ai u habit. U habit më tepër nga ash-përsia e zërit, sesa nga përbajtja e fjalëve. Do ta ketë nga zilia, tha me mend dhe tërroqi trupin përpala, por, apo bëri atë veprim, i hipi një dëshirë e marrë për ta parë atë njeri me çdo kusht. Ta shihnte pak, pastaj dinte ai se si të vepronate edhe me të. Befas vuri re se ajo kënaqësi që iu shkaktua në vesh e në gjoks pak më parë nga përmendja e emrit të tij, i ishte larguar e në ta i kishte mbetur si zhurmë acaruese zëri i ashpër i atij që foli nga mbra-pa. Thuajse ngriu në vend. E dëgjova vërtet emrin tim në raport, apo m'u bë se e dëgjova? Pasi u mendua pak, mundi të kuptonte, megjithëse nuk e dëshiron të kurrë, se e kishte humbur pusullen. Nga çasti në çast po i mbushej mendja se nuk e kishte dëgjuar fare emrin e vet në raport. As emrin e të birit. Vështroi nga drejtuesit e mbledhjes. Ata nuk po vështronin fare nga ai, madje iu duk se në sytë e tyre kishte ftohtësi. U rrëqeth.

— Heu! — ia bëri, si ka mundësi?! Ndoshta... Ndoshata...

Nuk kuptoi fare se si mbledhja kishte kalluar qëkur në diskutime. Mblodhi shpejt e shpejt veten. Gjeti një çast të përshtatshëm dhe, i shtyrë nga mendimi për t'u imponuar te të tje-

rët, për t'u njohur, në njëfarë mënyre prej të ardhurve, si dhe nga mendimi se pas diskutimit të tij mund të mbaronte mbledhja, u ngrit për të diskutuar. Do të zgjatej pak mbledhja (ai do të tregohej me diskutimin e tij njeri i kohës, sepse do të diskutonte bukur), po në fund të fundit... E filloj diskutimin pa u kollitur, (ai i urrente të gjithë ata që kolliteshin para se të flisnin). Foli, por pa kuptuar sa foli, sepse foli pa letër. Foli me shembuj, me fakte, me fjalë të zgjedhura. Tha, në thelb, se ajo që kishte bërë për shoqërinë nuk ishte gjë fare para asaj që do të bënte në të ardhmen. Në këtë çast, të cilin ai e quajti çast kulminant, dikush qeshi, por ai kishte punën e vet. Ai ishte në etapën e të treguarit njeri i kohës, paçka se miqtë dhe shokët e kishin gënjiyer, e kishin lënë në baltë. Tha edhe disa fjalë të tjera të mëdha, të zgjedhura, me përbajtje të shëndoshë (si ato që thoshte shpesh nëpër format e edukimit), dhe ul, i shoqëruar nga të qeshurat. Të gjithë e kanë nga zilia, tha me mend, pasi zuri vend mirë. Pas pak, kaloi në një hutim të pashpjegueshmëm, duke jetuar thellë shpirtërisht mungesën e emrit të vet në raport, shkaqet e mungesës dhe të tjera gjëra që lidhen me të. Me tërë qenien po i vërvshonte një inat i tërbuar për miqtë, për shokët. Por ndoshta... ndosh...

Zhurmën që shkakton zakonisht mbarimi i mbledhjes, e ndjeu shumë vonë. U shkund dhe u ngrit rrëmbimthi. Eci si somnambul. Ah, vëtëm po i gjeta, të poshtrit, mendonte për miqtë dhe shokët, do t'i pështyj në fytyrë! Vëtëm po i gjeta! Qindin do t'u punoj. Por, ndërsa mendonte kështu, dëshironte që të kishte ndodhur ndonjë keqkuptim. Ndosh...

Jashtë mezi iu përshtatën sytë. Dritat anës rrugëve i dukeshin çuditërisht verbuese, I puliti disa herë sytë, por kot Thua jse nuk vështron të asgjë. Vetëm mendja nuk donte t'ia dinte. Ajo u kërcenohej miqve dhe shokëve, që e kishin lënë në baltë. Herë-herë kishte përshtypjen, se ishte futur në një korridor të errët. Ishte futur vetë atje apo e kishin futur të tjerët, ende nuk po e kuptonte. Rëndësi kishte për të që ishte futur në një korridor të errët, ndërsa me duar kërkonte derën, prej nga do të dilte sa më parë. Duke vepruar ashtu, i përforcohej përshtypja se në atë korridor të errët ishte futur prej kohësh, por ai nuk kishte ndier gjë, ndërsa derën për të dalë prej andej kishte filuar ta kërkonte kohët e fundit.

Shtrëngoi fort dhëmbët dhe ia bëri disa herë «Ah», si ata që duan të shqyejnë dikë, pa qenë ende i sigurt se ai «dikë» ishte vetë apo ndonjë tjetër.

## Ligjëratë nga majë e pemës

Ti më hodhe dorën mbi sup dhe, pasi buzë-qeshe pak, fillove: Nuk ka gjë më të shtrenjtë për njeriun sesa të qenët i thjeshtë, more shpirt. Kur arrihet kjo, vijnë pastaj mrekulli të tjera të panumërtë, të cilat i sjell të jetuarit në bazë. Ja, unë, për shembull, shkoj shpeshherë në stane. Dhe, të them të drejtën, sa keq më vjen kur mendoj se nuk do të më kuptosh dot. Ç'mrekulli e rrallë është të shohësh hënën në netët e bukura e të pastra të verës, kur lëvrin si kunadhe midis degëve, ndërsa yjet llastohen tërë nojma rreth saj. Fresku i mbrëmjes të përkëdhel gjoksin e zbërthyer, shushurima e gjethëve, si shamiza gjelbëroshe, pëshpërin pa fund: «Mirupafshim, mirupafshim!» E mahnitshme është ajo zhurma karakteristike që lëshon qu-mështi kur bie në vedër! Vetëm një herë të kesh qenë në stan dhe çdo gjë nga këto që po të tregoj unë të del para syve sikur të jetë e

gjallë, të flet, të buzëqesh, të... Di kujt i thonë vedër? Ah! Këtu e kam frikën dhe unë. Kam frikë se nuک do të më kuptosh. E, mbushen vedrat me qumësht. Qumështi me shkumën e bardhë jo, më fal, me shkumën pak si të verdhë. E, pra, bie ky qumësht në vedër dhe sajon një melodi të këndshme, sikur në të të jenë mbledhur të gjithë tingujt më të dashur të botës. Pale qentë. Qentë, more, kur ndiejnë diçka të huaj pér stanicë dhe ngrenë veshët pérpjete, thuajse deri atëherë kanë qenë shytakë e u kanë mbi-ri atë çast. Pale kur lëvizin atë bishtin e butë si furçë frësht, frësht, si një gjymtyrë, që është krijuar vetëm pér të të përkëdhelur e pér të të thënë miqësisht: Eja, eja, miqtë janë të dëshirueshëm në stanicë tonë. C'mrekulli! E të mendosh disa tyryfylë që i kërkojnë mrekullitë në pér bulevarde dhe që rrezik të thonë pér ndonjë akacie në anë të tyre se është mrekullja e tetë ose e nëntë. Eh, fresku i mëngjesit! I mahnitshëm! Po, le të flasim pér jetën në kasolle. Përrallore fare! Fantastike, desha të them! Shkova njëherë në mal, midis shumë herëve të tjera Barinjtë i kisha shokë. Nuk u kisha thënë fare se do të veja. E bëra qëllimi këtë, sepse të papriturat janë gjithmonë të bukura. U ngjita pérpjete, sikur të isha pupël, jo burri tetëdhjetë kilogramësh. Sa eca pak, kur... frap, një alamet qeni! M'u lëshua gati të më shqyente. Llogarita me saktësi se në ç'largësi do t'i kishte veshët kur të hidhej. Do t'ia kapja mënjerëherë. Ama, duhet gjakftohtësi. Pika më e dobët pér qenin, xhani & vëllait, janë veshët. Ai, sic thashë, më ishte lëshuar. Dhëmbët e parë si dhëmbë sfurku. Vrik duart dhë ia mbërtëva veshë fort. Nuk e mbajta as një sekondë ashtu, por,

sapo ndjeva se in'u mbushën duart me llapat e tyre, i rrotullova fort. Bashkë me mua rrotullohej edhe qeni. Pip me gojë. Habitesha pér fundin e asaj trimërie. Këmbëmbledhur, qeni prishte nga do ta flakja unë. Dhe në çastin kulminant e flaka. Bllamp, ra diku. Unë thashë se aq e pati, por dola i gënjer. Ai u ngrit menjëherë. Më vështroi me lemeri. Futi bishtin' në shalë. Iku.

Më hipi në kokë një inat i tèrbutar pér barinjtë. Si ma punuan kështu?! Pyesja veten, ndërsa ecja drejt kasolles, duke iu ruajtur ndonjë qeni tjetër. Duheshin marrë përséri masa. Një mendje më thoshte se mos kisha ngatërruar stanin, ose kishin ndërruar barinjtë vendin e stanit. Por jo. Sa u ngjita pak më lart, shoh se ai qen, që deshi të më shqyente, nuk ishte i stanit ku do të veja unë. Eh, u nxeha kët me shokët barinj.

Bramp, në vathë unë. Qentë hiç. duket qeni që të njeh, sado që ta ndërsesh. Më i madhi tundi bishtin, sikur donte të thoshte: «Hyni, hyni, po na fyeni me drujtjen tuaj!» Tungjatjeta, burra, thashë dhe qafë pér qafë me shokët barinj. I vura re që u prenë në fytyrë, megjithëse ishin njerëz që nuk e jepnin veten. U thashë që të mos sëkëlldiseshin shumë, se po veja atje vetëm pér të biseduar, pér qejf, si i thonë fjalës, pér bukë e kripë e zemër. Po pse, i mbajta, thua ti?! Meazallah, punë që s'bëhej. Të shihje ti, një andej e një këtej, u vunë të gjithë në lëvizje. Dhentë sapo i kishin mjelë. Vedrat dhe bidonët plot. Apo s'ishin mirë edhe me planin! Sa të hapje e të mbyllje sytë, u sajua sofa përpara meje. Se mos të të shkojë mendja pér ndonjë nga ato tavolinat tek «Arbëria» ose

te «Tirana», ore lum xhani. Ato nuk i kam qejf fare unë. Asnjë cep të syrit nuk më zënë ato mua. Thjesht, ore, thjesht, fare, fare thjesht. Zjarri diku afër derës. Brambullinte zjarri. Ishte rregulluar në atë mënyrë, që të linte brenda në kasolle fare pa tym, se, lum shpirti, pa pak tym, thuaj ç'të duash, nuk ka lezet fare. Ne, të vendosur rrëth zjarrit, por duke zënë vetëm tri anë të tij, treçerek rrëthi. Kjo po, mund të quhet mrekullia e tetë ose mrekullia e nëntë. Një batanije e gjelbër përpëra. Në anën e zjarrit një dru i trashë për të penguar dyndjen e prushit nga ana jonë. Ne ishim ulur shesh mbi guna. Mbi batanije: mishdhie të egër që lëshonte avull, salcë kosi që dukej se ishte nxjerë nga frigoriferi. Qepë dhe hudhra të njoma, si tubere zymbylash. Buka ishte prej misri. Kjo ishte qendra e mrekullisë. Rakia: ballë kazani.

U thashë se e tēpruan dhe më fyen me gjithë atë përkujdesje, por nuk u hoqa as mënjanë, sepse nuk doja të isha unë ai që fyera, po të mos më kishin fyer ata. Një mendje më thoshte të mos viaj gjë në gojë, ngaqë herë-herë, dyshoja se mos pas asaj përkujdesjeje fshihej ndonjë proçkë, por çne, nuk ishin nga ky brumë ata... Pastaj... ata e dinin që në kurriz të punës unë nuk lejoja as qimen.

Në qoshe, pranë zjarrit, aq sa mund t'i prekja unë me këmbë, ishin vënë drutë për të ushqyer zjarrin. Atë punë do ta bëja unë.

Filloi muhabeti, të kam rixha. Dera e hapur. Përballë meje një hapësirë e pafund, që kufizohet nga konturet e disa maleve. Mishi mish, siç thashë, dhi e egër e njomë. Rakia raki. Muhabeti muhabet. Kënga këngë. Këngë të

shtruara. Këngë me dallgë. Lashë nam atë natë me këngë. Kulmi qe kur doli hëna. Ngadalëngadalë, si një që ishte nisur nuse diku prapa maleve dhe shkonte në derën e burrit, e mbytur në lot lumturie...

Shkriheshin drutë në zjarr. Kërr, ia bënte prushi. Hidhmëni të tjera, thoshte ai, kam uri. Dhe kishte vërtet uri. Unë, fap me majën e këmbës druve që ishin vënë për atë punë. Ato fup mbi zjarr, me një zhurmë të mahnitshme. Flaka e zjarrit i përpinte ato, siç përpinim ne mishin, salcën e kosit, qepët dhe hudhrat e njo-ma. Në cepin e derës, në gjysmëmur, si një shami e bardhë, bishti i qenit, sikur thoshte: «Bëni qejf ju, jam unë këtu!»

Eh, ç'qen ishte!

Hëna ngjitej lart. Yjet rreth saj, si krushq, tashmë të ngazëllyera. Zjarri në kasolle më-njanonte flakën herë-herë, sikur i përshëndeste. Bisedë e tokës me qiellin. Ne, siç thamë, ulur shesh mbi guna, si Anteu mbi tokë.

Vonë, as që na shkonte mendja të shihnim orën, dolëm për të bërë një shëtitje. Ajo mund të quhej mrekullia e dhjetë. Qetësi e thellë. Po të mprihje mirë dëgjimin, dëgjoje shushurimën e një rrëkeje të largët, që zbriste nga shpati i malit. Ujë dëbore. Uji i dëborës ka një zhurmë të veçantë, ndryshe nga ujërat e tjera. Eh, ç'ta zgjatim me këto.

Shumë vonë ramë për të fjetur. Mbi guna të reja. Gunat e reja kanë lesh të shndritshëm, të gjatë dhe rrëshqitës. Hodha edhe një herë dru në zjarr me majën e këmbës, para se të më mundte gjumi, pa harruar edhe një për-shëndetje për hënën. Yjet nuk i shihja më. Hë-na kishte shtuar dritën dhe ato nuk dukeshin.

Duhej të ishte prag mëngjesi. Kjo gjë ndodh vetëm atëherë.

Auuu, auuu, dëgjoj nëpër gjumë, si një ash-kël të mprehtë që më gërvishitte veshët. Frap, ia bënë çobanët. Tutje ngutej e lehura e qenve. Vendi nuk më mbante më. Përpjetë dhe unë. Nuk pashë ku i futa këmbët. Doja vetëm të dilja përjashta. Ujk kisha parë vetëm në filma dhe në kopshtin zoologjik. Pra, po më jepej mundësia të shihja ujk në natyrë, në mal, para vetes, ashtu të egër, si të them, ujk origjinal. I bëra sytë katër. Doja të shihja ujkun. Qentë lehnin egër. Dhentë ishin shtyrë në vathë. Nguteshin. Barinjtë sokëllinin. Gjëmonte mali. Ika më tej, andej nga mendoja se mund të ishte ujku. Nuk e kisha mendjen në vend fare, kur para syve, fare pranë, kaloi ujku, rrëshqanthi. Në qafë kishte hedhur një dele. Desha të thërritja, por nuk kisha zë. Isha bllokuar. Ujku, po të pa më parë, të zë gojën. Pra, ai m'i kishte hedhur sytë i pari. Pas pak atë e ndoqën qentë. Mua atëherë më erdhì zëri. Thirra, por qe tepër vonë. Ujku, i ndjekur nga qentë, qe larguar shumë.

U mblodhëm përsëri në kasolle. Gjumi nuk bënte më fole mbi qerpikë. Ishte trembur. Dola jashtë. Më pëlqente fresku. Rrezet e hënës krijonin rrjetë midis degëve të aheve. Gjethet fërférinin... Tabani, shpirt, tabani është gjë e madhe. Të këshilloj të bësh sa më pak jetë zyre...

Kështu fole ti atë ditë. Dhe unë të dëgjova me vëmendje. Të dëgjova me vëmendje sepse nuk desha të të fyeja. Të gjitha ato fjalë ti i kishe gënjeshtra. Gënjeshtra me brirë. E vërteta ishte krejt ndryshe. Ti, Karafil, shkove

vërtet në mal. Shkove me atë shokun. Ishte e shtunë pasdite. Ti ndiheshe i gjuar dhe flisje shumë. Te burimi në këmbët e malit u çlodhët pak. Uji ishte i ftohtë. Ujë dëbore, që dilte si papritur nga një e çarë shkëmbi. Mbi ju, pak lart, ishin lerat. Pas mesit të natës në ato lera pinë ujë dhitë e egra, të tha ai shoku. Ti u habite, megjithatë nuk e dhe veten. E di, e di, the dhe qeshe. Rreth jush cicërima zogjsh të lumtur. Ti kishe mbetur i mahnitur nga cicërimat e tyre. Ishin zogj të tjerë, nga ata që rrinë vetëm në mal, dhe gjatë dimrit strehohen në-për guva. Ata edhe këngën e kanë ndryshe. Edhe fëshfërima e gjetheve të kishte bërë shumë përshtypje.

Dhentë ishin mjelë kur arritët ju. Ato ishin shpërndarë në shpatin e malit, siç shpërndan era petlat e luleve. Ruhu, se mos të lëshohet qeni, e këshillova shokun. Ai qeshi, por nuk tha gjë.

Te hyrja e stanit ju priti Peçi. Ai ishte kryebari i kopesë. Pas tij u takuan me ju Zaimi me Mamushin. Na falni që nuk ju lajmëruam më parë, tha shoku. Atëherë ju sapo ishit ulur mbi kërcunj të sharruar. C'janë këto fjalë, tha Peçi, në kështu i duam miqtë.

Zërin e kishte të mprehtë dhe tingëllues. Ti e shikoje si diçka shumë të rrallë. Na bëtë qejfin okë, tha pastaj ai. Ti shtrëngove ballin me majat e gishtave. Mua nuk më rrihet pa bujtur të paktën katër pesë herë në vit nëpër stane, the i ngazëllyer ti, duke rregulluar pantalonat te gjunjët. Bën mirë, të tha Peçi, ky Takja është qull nga kjo anë. Qyq më qyq na vjen. Peçi ju shtroi përpara sallatë dhe salcë kosi. Për salcën ju tha se ishte përgatitur nga

qumështi i dhive të egra. Ti the se qumështi i dhive të egra është shumë i mirë. The kështu dhe more pirunin në dorë. E afrove përparrasyve. Bëre sikur lexove diçka në të dhe e fshive me pëllëmbën e dorës. Pirunët janë të Gjirokastrës, të Metalikes, të tha me qëllim Peqi. Po ti nuk kuptove gjë. Dhe the: ua ka marrë dorën mirë këtyre.

Peçi hodhi dru në zjarr. Mbi flakë u ngriten shkëndija të trembura dhe ti i mbledh breshkakur ndien rrezikun. Është ngrohtë, the tif, se të vinte zor të thoshe ndryshe. Peçi tha se zjarrin e kishte marrë uria dhe me një dru, që e përdornin si mashë, i hapi zemrën prushit.

Pas një ore Mamushi me Zaimin nxorën mish. Ti nuk ia ndaje sytë mishit. Mishi ishte i majmë, siç është mishi i qengjit në fund të qershorit. Dhité e egra janë të shëndosha, the ti. Kjo ishte më e dobëta, tha Mamushi serioz. Po, po, ia bëre ti dhe nuk ia ndaje vështrimin mishit. Nga kjo dhi e egër bëmë trembëdhjetë kile salcë vjet, tha Peçi. Më shumë duhet të kishit bërë, vërejte ti. Shoku yt qeshi dhe tha: Nuk ia merrnin të gjithë qumështin, ia linin një pjesë për kecat. Sidoqoftë, nuk u tërhoqë ti. Do ta kemi parasysh sivjet, tha Zaimi.

Peçi shtrroi batanijet, të vjetra dhe të reja. Mbrapa palosi gunat.

Para se të shtriheshe për të fjetur, zhveshë pantallonat, këmishën. I palose dhe i vure si jastëk te koka. Mos u zhvish, se do të të çjerrë guna, të këshilloi Mamushi. Zaimi me Peçin flinin përjashta, në shtretër të sajuar në për degët e aheve, një mbi një, nën vathën e dhenve. Ti e vështrove në sy Mamushin. Ku

di ti, i the dhe u shtrive. Ti e kishe trupin të bardhë, këmbët të holla si cingël.

Gjumi nuk të zuri fare. Përpëliteshe në rroba sikur të ishe kukurec mbi prush.

Vonë, një zë thërriste: «Ujku!» Qentë lehnin të alarmuar. Sokëllima barinjsh. Mamushi doli jashtë si erë. Ti nuk lëvize fare dhe fillove të gérhije. Takja të hodhi dorën në sup dhe të tundi. Ti nuk lëvizje fare. Ai të thirri në emër. Ti hiç. Takja u ngrit dhe doli përjashta. Ti u ngrite ngadalë, hape me gishta një vrimë të vogël në gardhoren e kasolles dhe vështrove përjashta. Kur hyri Takja në kasolle, ti u shtrive përsëri në rroba dhe gérhite gjatë. Takja të tundi fort. Zérat përjashta po shtyhesin tutje. Ti vazhdoje të gérhije dhe nuk u bëre i gjallë të lëvizje. Takja të tundi përsëri, të foli në emër. Zérat jashtë kasolles kishin reshtur. Ti lëvize pak. Ra ujku në kope, të tha ai, pse nuk dole? Ti bëre «ee», sikur nuk besove. Ujk dhe çfarë ujku, të tha Takja. Pse nuk më zgjove, i poshtër, shave ti dhe u ngrite përgjysmë. Të thërrita, po ti nuk dëgjoje, shpjegoi Takja. Ah, kur s'më zgjove, i poshtër! shave përsëri. Të thirra e të tunda, theksoi Takja. Të më kishe shkulur si leckë, vërejte ti.

Vonë të mundi gjumi. Dhe vonë u ngrite në mëngjes. Bënte fresk. Gjethet e pemëve ishin rënduar nga vesa. Në majën e malit përballë ishte përhapur një mjegull e hirtë, si një jelek i hedhur krahëve. Dielli, i ndarë përgjysmë, t'u duk si një mollë e stërmadhe futur me vësh-tirësi në xhepin e këtij jeleku. Ia the këtë kra-hasim Peçit dhe qeshët të dy. Pastaj Peçi të pyeti çfarë do të hanit për mëngjes. Salcë nga ajo e dhive të egra, the ti dhe nuk lexove në sy-

të e Peçit mëndimin: «I mjeri ti!» Salca e dhive të egra u mbarua mbrëmë, po kemi pak salcë nga qumëshти i sorkadheve, tha ai. Mrekulli, u ngazelleve ti dhe u ule pranë zjarrit. Takja qeshtë, me fytyrë të kthyer nga ana tjetër.

Hëngrët të dy më nge. Ishtë e diel. Do të zbritnit poshtë me Zaimin, që do të conte qumështin në baxho. U takuat me Peçin e me Mamushin dhe u nisët. Peçi ju luti që t'u shkonit përsëri për vizitë, sepse, sidomos ti, u kishe pëlqyer shumë në muhabet. Do të vijmë patjetër, premtove ti. Ngrite pëllëmbën lart dhe ike.

Rrugës ju të dy mbetët pak mbrapa. Dhité e egra nuk duhet të vriten, i the Takes. Po, miratoi Takja, vrajja e tyre është ndaluar me ligj. Desha të them se nuk duhet të llapim gjekund për vizitën tonë në mal, këshillove ti. Jo, nuk duhet të llapim, tha Takja.

Pastaj me të nuk u takove më. Ti bëje sikur nuk e vije re dhe i shmangeshe. «E, ç'kemi ndonjë të re andej nga mali?» i kishte thënë një ditë i plotfuqishmi i zonës shokut tënd, Takes. Takja kishte qeshur. Kishte qeshur, sepse e kishte marrë vesh që ti e kishe mbajtur fjalën për ato dhité e egra. Për dhité e egra, njérën nga të cilat e hëngrët ju atë natë, kur ti e kishe të disatën herë që shkoje në bazë, si... kuadër.

Pse më vështron sikur, nuk më ke parë kurrë?!

## Z h g ē n j i m

Mjeku i ri Ruçi Tollovina nuk ishtë nga ata njerëz që dehen shpejt. Nuk e kam fjalën të dehja nga pijet, sepse ai, përveç, bërrës, nuk pinte asnjë pije tjetër alkoolikë, por atë nuk e dehet asgjë që mund të jetë e aftë për të dehur njeri. Kishte thuajse dy ditë që po udhëtonte hipur në mushkë, nëpër një terren të thyer dhe shumë të thyer, mbi të cilin bënin jetën e tyre disi të çuditshme lloj-lloj drurësh.

Pumonte në poliklinikën e qytetit dhe stërvitjen ushtarake e kryente në prapavijë. Pra-pavijë. Ai shkëpuste shpeshherë fjalën përbërëse vijë dhe ndërtonte me të lloj-lloj fjalësh: Vija e parë e frontit, vija e parë e sulmit, luftë në skalionin e parë. Vija e... Ai nuk kishte të bënte fare me ato vija. Ai shërbente në pra-pavijë dhe çdo gjë i bindej këtij fakti. Të shërbesh në prapavijë, do të thotë p.sh. të mos mendosh kurrë se mund të ecësh mië këmbë, do

të thotë, gjithashtu, të mos presësh për të ngrënë ushqimin ato oraret ose pushimet e kronometruara, që shpeshherë komunikohen nga eprorë të rreptë. Uff!

Jeta për të kishte filluar të bënte shtratin e vet, shtrat të cilin ai e ndiqte me shumë kujdes. Dy vjet kohë që e thërritën mjek. Mjek. Me shokë shumë, me autoritet...

Mushka tronditej pak gjatë ecjes. Ai lëkundej pak mbi samarin e mushkës. Rruga i ngjitej me kthesa një shpati të pjerrët, si një gjarpër i stërmadh dhe i lodhur. Kishte dëgjuar se kishin hyrë në rrëth tjetër. Për të nuk kishte rëndësi se ku ecnin sepse ai nuk ishte as gjeolog as topograf. Ai ishte mjek dhe duhej të mendonte vetëm se si duhej ta kryente këtë detyrë. Herë-herë e trishtonte ndonjëfarë pasiguri e lehtë, por ai e hidhte atë shpejt mbrapa krahëve, siç shfletohen në një libër faqet e mëritshme. Ai nuk kishte pse të shqetësohej, sepse kishte dalë në shkollë me dhjeta dhe... pastaj... ajo puna dyvjeçare në klinikën e qytetit a nuk përbënte në vetvete një përvojë bindëse?

Pjerrësia mbi të cilën zvarritëj lodhshëm rru-  
ga mbaroi. Mushka ecte në një rrugë të sheshtë,  
me kthesa, midis shkurresh e lajthish. Në krah  
të djathtë ngrihej mali. Mbi trupin e tij laj-  
thishët dendësohej, ndërsa midis saj gjallonte ndo-  
një dru bredhi, si rojë midis atij gjelbërimi de-  
hës.

Veshi i kapi fjalë të një këngë dhe ai tër-  
hoqi kapistallin. Mushka qëndroi.

*Kur s'të bëra dot manare,  
më fute në rrugë dhiare,  
më humbe nga sytë fare.*

Vargjet e këngës i dëgjoi qartë. Ajri i pashët i malit ia çoi në veshë, të shkoqura, si kokrrat e tespiheve, dhe ai mundi të dallonte në to njëfarë brenge dhe dhimbjeje. Qeshi më ve-te dhe lëshoi frerin e mushkës. Njerëz pa takt me femrat, tha me mend dhe qeshi përsëri.

Mushka tronditej më pak gjatë ecjes. Ai lë-kundej më pak mbi samarin e mushkës. Ngadalë-ngaçnale po ndiente se vrimëzat e hundës po i zgjeroreshin, se kraharori po i zmadhohej, ndërsa një marramendje e pakuptueshme i mjegulloj pak vështrimin. Ndjenja e profesionit e shtyu të gjente shkaqet e asaj gjendjeje, por, në vend që të gjente diçka bindëse dhe të përcaktonte drejt shkaqet, tha me vete: «Unë udhëtoj për herë të parë në vende të tillë». Dhe vërtet, ai udhëtonte për herë të parë në një peizazh aq të gjerë. Ai kishte shkuar deri nga liqeni i Tiranës dhe kujtimet për të ngatërhoreshin çuditërisht me karrocën e fëmijërisë, të cilën e shtynë kujdeshëm dora e mamasë (ai deri vonë i thoshte mamake), ose dora e babit. Kur kishte pasur raste të vente në Dajt me shokët, ose në marshime të organizuara në drejtime të tjera, ai kishte siguruar raport për paaftësi dhe nuk kishte shkuar. Ai do të bëhej mjek, nuk do të bëhej gjeolog...

Befas dëgjoi kollë. Pati përshtypjen se di-kush i gërvishти me përdhunë mendimet. Ktheu me përtesë kokën prapa. Pas tij, disa hapa larg, çapitej Tekiu. Pak më parë i kishte thënë se dyshonte për të ftohtë. Ja, sa të arrijmë, në fu-shim, kishte shtuar. Tekiu nuk i kishte thënë gjë tjetër. Tani çapitej disa hapa larg mushkës. Mbi mushkë kishte hipur ai, mjeku, por e ki-

shte ndihmuar Tekiun. I kishte marrë mbi mu-shkë çantën e shpinës dhe kapotën ushtarake.

Ruçi Tollowina tërroqi pak nga vetja kapistallin dhe mushka qëndroi. Tekiu shpejtoi hapat. E ariti. Ù koll përsëri.

— Pak më tej do të gjejmë ujë, — tha Tekiu nga mbrapa. Mjeku ktheu kokën.

— Nga e di ti, o Teki?! — pyeti pa mundur të fshihet një fije mosbesimi e talljeje njëko-hësisht.

— Ma ndien veshi, — tha Tekiu i sigurt, duke fshirë djersët me mëngën e xhaketës.

— Ehe! — ia bëri mjeku. Këmbët e tij bënë dum-dum mbi barkun e fryrë të mushkës.

Mushka ecte me hap të shtruar. Ai e ndiente veten mirë mbi samarin e mushkës. Rruja gjarpëroi edhe pak nëpër lajthishtë dhe u fut papritur në lëndinë. Para tij u shfaqën çadrat dhe ushtarë që çlodheshin. Deshi t'i thoshte dicka Tekiut, por nuk mundi. Se ç'ndiente dicka në gjoks që e pengonte. Pyeti pa iu drejtuar kujt se ku mund të ishte çadra e ndihmës së shpejtë mjekësore. Një ushtar, që rrinte shtrirë, u ngrit përgjysmë dhe ia tregoi me gisht. Çadra ishte e madhe, pak e mënjanuar nga shqet, me litarë të tendosur dhe me kulm të pjetrët. Mbi kulm kishin hedhur gjethë.

— Clodhu pak, pastaj eja të të vizitoj, — i tha Tekiut. Hoqi nga samari pajimet e tij dhe u nis për në çadër. Gjatë rrujës pa përsëri ushtarë që çlodheshin. Tek unë do të vizitoheni të gjithë ju, tha me mend. Në gjoks ndjeu një fërgëllim përkëdhelës. Eci disa hapa, dhe qëndroi, si një njeri që kujtohet papritur se ka harruar dicka, për të cilën ecja më tej është e kotë. Lëshoi përtokë pajimet dhe u kthye me-

njëherë mbrapa. Duhet të kontrolloj kuzhinën dhe ujin, tha me mend dhe nxitoi.

Burimi ishte nën një ledh të vogël. Uji rriddhe nëpërmjet një kupe të gurtë. Anës, sidomos nën të, kupa kishte zënë myshk. Buzët e gurtatë kupës ishin pak të ngrëna, si duket ngaqë në to mund të kishin mprehur thikat.

— Pastaj këtë kupë nuk dua ta shoh këtu, — tha me zë urdhërues dhe filloi të freskohej. Nuk mori asnje përgjigje për urdhrin që dha. Vetëm dy prej ushtarëve e vështruan të habitur. Ai kuptoi se duhej të thoshte edhe diçka dhe shtoi: — Kupat janë bartëse të rrezikshme mikrobesh. Të zëvendësohet kupa me ndonjë tub.

Përsëri asnje përgjigje. Njëri nga ushtarët zbërtheu më tepër xhaketën, përvëshi jakën dhe mjeku pa në gjoksin e tij muskuj dhe lesh të dendur.

— Unë u bëra kaq, o doktor, e nuk më ka gjetur gjë, — tha ushtari me gjoks të zbërthyer, duke e goditur atë me pëllëmbë.

Mjeku Ruçi Tollovina u përtyp, sajoi shpejt e shpejt një përgjigje që e quajti të thekur dhe u mat të fliste, por nuk mundi. Sytë i zunë Tekiun, të hequr pak mënjanë dhe fjalët imbetën në fyt.

Hodhi edhe një grusht me ujë në fytyrë dhe shkoi në kuzhinë. Vështroi, pyeti, dha urdhra. I thanë të hante diçka. Nuk pranoi. Kishte gjumë.

Rrugës për në çadër solli me mend vlerat e mëdha të gjumit pas një marshimi të vështirë hipur në mushkë. Gjumi është...

U zgjua papritur nga një thirrje e fortë si ulërimë. Kokën e kishte të rëndë dhe i dhimb-

te pak në tëmtha, Thirrja e fortë u përsërit. Zihën idiotët, tha me mend dhe u ngrit. U habit kur vuri re se kishte fjetur pa zhveshur pantallonat dhe xhaketën, kundër rregullit të tij të përditshëm, por nuk kishte kohë të mendonte si kishte ndodhur që kishte fjetur ashtu; thirrja si ulërimë e ndillte për ndihmë. Doli nga çadra pa ditur se ç'drejtëm të merrte. Sido që të ndodhë, përgjegjësia bie edhe mbi mua, arsyetoi dhe eci përpara.

Rrezet e diellit binin pjerrtas mbi lajthi-shtë. Deshi të pyeste se çfarë po ndodhë, pörnuk mundi të haptë gojë, sepse thirrja e fortë si ulërimë u përsërit për herë të tretë, veçse këtë herë më e fortë dhe e ndërprerë nga fjala «ndihmë», e cila ishte më tepër një gulçim, sesa një-fjalë e qartë. Hodhi vështrimin andej nga u dëgjua thirrja dhe shpejtoi hapat. Rruga përatje kishte qenë pak e përpjëtë. Reshtat e rregullt të çadrave dhe njëfarë mjegulle e holle dhe e kaltëreme, që sajhej ndoshta nga tymi i zjarreve të kuzhinës, e kishin penguar përtë parë që më parë një kasolle stani. U ndodh para saj fare papritur dhe, i shtyrë nga ndjenjë e frikës (e cila shndërrohej në lemeri, kur përfytyronte plagët që mund t'i shkaktonte qeni: zorrët përjashta, mishin e kofshëve, të pulpëve copë-copë, shtoju këtyre edhe rrrobat e shqyera dhe, tmerr, mungesën e një mjeku tjetër), përipiu me një vështrim të shpejtë vendin, rrëth e rrëth kasolles. Syri i pa një qen të madh e të bardhë, që e vështronë krejt i qetë. I hipi inati ngaqë nuk pa njeri afër kasolles dhe më shumë i hipi inati për ata hajvanë (kështu tha ai), që kishin gjetur atë kasolle për t'u grindur, ndërsa kishte shesh dhe pyll plot. Deshi të thë-

rriste që të mbanin qenin, por nuk thirri dot. Ndoshta do t'i dukej vetja si fëmijë, ndoshta ndiente diçka tjetër, po ndërkaq ai po ecte, dhe qeni, kur ai iu afrua fare pranë, filloi të tundtë bishtin. Nuk pati kohë atë çast të habitej me atë butësi të qenit, sepse nga dera e kasolles, ndoshta nga të gjitha anët e saj, dilnin gulçe dhe rënkimë të një njeriu që mund të ishte duke dhënë shpirt. Ndoshta është tepër vonë, arsyetoi disi i turbullt dhe u fut me vrull brenda. Sytë iu mjegulluan papritur. Nuk shikonte as gjë, por edhe me gojë nuk foli. Pas pak vështrimi iu qartësua dhe ai mundi të dallonte tre burra, që rrinin më këmbë, fare të qetë. Nuk u besoi syve dhe i fërkoi me shpinë e dorës. Tre burrat e vështronin qetësisht, ndërsa ai shkoi atje me mendimin se do të gjente njerëz me sy të çapëlyer, të kuq, me fytyra të çjerra e të gjakosura. Ah, c'është kjo ndjenja e përgjegjësisë... Ndërsa ishte duke jetuar këtë zhgënjim, u tremb nga një thirrje e fortë, e shoqëruar nga rënkimë si gulçe e nga fjala «ndihmë». Iu duk se zëri doli nga dheu dhe bëri, gati duke u vërvitur, një hap mbrapa. Ecja, ose më saktë hedhja një hap mbrapa i dha kohë të mblidhët veten dhe të shikonte para këmbëve të tij fytyrën e prushëruar e tërë djersë të një njeriu. Nën lëkurën e fytyrës damarët të jepnin përshtypjen se do të pëlcitnin në çast. Po trupin, ku e ka trupin ky njeri?! pyeti i lemerisur dhe fërkoi përsëri sytë. Dalloj se trupi i atij njeriu ishte futur në pleh.

— C'bëni kështu, more të marrë?! — gati ulériu dhe u përkul mbi trupin e mbuluar me pleh. Një dorë e fortë e kapi nga supi dhe e ngriti lart. Vështroi njeriun që e kishte kapur.

Ai kishte vënë mbi bûzë gishtin trëgues. Mjekut Ruçi Tollòvina iu duk alarmante kërkesa e tjetrit për të mbajtur qetësi në një rast të atillë, që kërkon veçse të ulërish. Por nuk ulëriu, as foli, veç vështroi edhe një herë tre burrat që kishte përparrë. Dy prej tyre ishin veshur si barinj. I treti ishte veshur si të gjithë qytetarët, me pantallona e me xhaketë doku. Këtij ia nguli vështrimin në ftyrë, pa mundur të fshihtë habinë. Tjetri i buzëqeshi dhe i bëri shenjë që të rrinte i qetë.

Ruçi Tollovinës iu qartësua plotësisht vështrimi dhe mendja. Njeriu i mbuluar me pleh vazhdonte të rënkonte, por ai nuk habitej më. Ishte shndërruar në çast në një fëmijë kurestar, që do të dijë patjetër zhvillimin e ngjarjes. Filloi të përpinte me sy çdo gjë që ndodhej brenda në kasolle. Mbi truallin e saj mundi të shikonte disa libra. Njëri prej tyre ishte në gjuhë të huaj. Të tjerët shqip. Më tej, të hedhura pa kujdes, ndodheshin tufa ësimësh të ndryshme, të thata e të njëma, të cilave ai nuk ua dinte emrat. Fare pranë togut me pleh pa dy lëkurë të mëdha deleje ose dashi (ai nuk i dallonte mirë ato) dhe dy tre peshqirë të pastër. Ngjitur me ta ishin hedhur kuturu rrabatë posazhveshura dhe një çantë me dorezë prej igeliti.

Thuajse kishte ngrirë në këmbë. Ishte bërë në atë kasolle një i pestë i heshtur. C'do të bëjnë me këtë njeri?! Këtë pyetje bënte vazhdimisht më mend. Në vend të përgjigjes, shihte para syve një rrjetë notash në librezë, firma e leksione, që ia pengonin pamjen. Bëri një stërmundim të lodhshëm për të shtrydhur kujtesën; por nuk nxori gjë prej saj. Ndoshta

kjo që po bëjnë këtë nuk lidhet me to, arsyetoi turbull.

Burri që ishte veshur si të gjithë qytetarët u tha dy të tjerëve që ta zbulonin njeriun e mbuluar me pleh, ndërsa vetë hapi mbi truall dy lëkurët e deshve.

I mbuluari me pleh ishte më tepër një skelet. I skuqur jashtë çdo përfytyrimi dhe shumë i djersitur, ai ngjante me një copë truall, mbi të cilin lëvrinin rrëke të panumërtë. Duart dhe këmbët ia kishin lidhur fortë ai nuk lëvizte dot. I ab shkundën mirë plehun, e fërkuan fort me njërin nga peshqirët dhe e mbështollën shpejt me lëkurët. Pastaj e lidhën fort.

— Nuk kishim ç't'i bënim tjetër, — tha ai që ishte veshur si të gjithë qytetarët. — Mjekët jashtë ia kishin prerë shpresat. Uji i këtij mali dhe kjo që po i bëjmë...

Mjeku Ruçi Tollovina nuk dëgjoi më. Përpipi me sy njeriun që foli, pastaj librat shqip e në gjuhë të huaj, tufat me lloj-lloj bimësh dhe u kthyesh rrëmbimthi, pa thënë asnje fjalë.

Doli përjashta. Në sy iu përplasën rrezet e diellit, i mbajti një çast mbyllur. Pastaj i hapi fort, sikur të donte të përpinte tërë botën. Eci dhe disa hapa. Ushtarë të shkujdesur, që thumbonin njëri-tjetrin me shaka, lëviznin gjithandej. Si ka mundësi të mos i këm gjetur në përkthimet e mia këto lloj trajtimesh. mjekësore?! pyeti veten. Vazhdoi ecjen, ndërsa iu kujtua një shok i kursit, i cili kishte filluar shkollën e lartë pasi kishte punuar disa vjet në pér fshatra si punonjës shëndetësie.

Në krah i kaloi Tekiu. Kishte mbushur pagurin me ujë dhe po ngjitej drejt kasolles. Me vështrim të ftohtë, mospërfillës. Ai nuk ka pér

Î'u vizituár tek unë, mendoi i dëshpëruar Ruçi Tollowina. Nuk deshi të shikonte asgjë, por, kundër dëshirës së tij, vështrimi iu lag mbi kupon e ujit, te burimi. Ajo ishte atje, e përjetshme, me gjuhën gurgulluese të ujit nxjerrë përjashta, sikur e përqueshte. Dy ushtarë laheshin me ujin që buronte andej. Ja, ata pinë edhe ujë me grushte. Lëshuan edhe pasthirrmë kënaqësie. Ahhh! Ishin ushtarë të tjerë. Ndjeu dëshirë të shtrihej, por shpejt ndryshoi mendim. U përhoq të largonte nga koka çdo mendim, të paktën për një çast, por e pati të pamundur.

## Shoqërore

Drejtori ynë kishte edhe këtë të mirë: para se të thoshte «mbledhja mbaroi», thoshte «Pritni dhe pak, se mos kemi lënë ndonjë material tjetër pa punuar». Thoshte kështu dhe kërkonte me sy e me duar në toqun me letra që mbante përpëra.

Kështu bëri edhe atë pasdite. Ndërsa ne thuajse ishim çuar të gjithë më këmbë, ai tha që të pritnim edhe pak, duke u ardhur në ndihmë fjalëve edhe me vendosjen e pëllëmbës përpëra. Ne iu bindëm, domethënë nuk dolëm fare nga bankat (mbledhjet i bënim zakonisht në një klasë, të cilën e përgatitnin dy-tre nxënës), dhe pritëm ç'do të lexonte tjetër drejtori. Ai tha «A, po, e gjeta edhe për pak na shpëtoi!» dhe lexoit:

— Nora me Dimon do të shkojnë për të bashkërenduar shqetësimet tona me të prindërve në fshatin Kodras. Shaqoja me... — unë nuk

desha tē dëgjoja q'do tē lexonte mē poshtē, se-pse detyrën time e kisha marrë. E vështrova Norën nē sy dhe i bëra shenjë me dorë pér t'i thënë se a dëshironte personin tim nē një udhëtim tē atillë, pér «bashkërendim te....» Nora mē bëri shenjë tē kthehesha mbarë e tē dëgjoja. Iu binda.

— Nisja do tē bëhet shpejt pér nē fshatra. Unë nuk kam aspak qejf tē dëgjoj fjalë! — tha drejtori kur unë u riktheva nga ai. Ai fu-ti letrën midis fletëve tē një regjistri tē madh, mbi tē cilin shkruhej «Të kryera» dhe u ngrit.

Drejtori ynë ishte rrëth dyzet vjeç. I pamartuar. I gjatë. Ekte pak shtrembër, por kjo mënyrë tē ecuri nuk e shëmtonte aspak. Kokën gjatë ecjes e mbante tē anuar nga një krah, thua-jse gjysmën e saj e kishte më tē rëndë se gjysmën tjetër. Të tjera gjëra pér tē nuk dija dhe nuk kisha si tē dija, sepse ai ishte muaji i dytë i punës nē atë shkollë. Ishim gjashtë mësues me gjithë drejtorin. Brenda nē gjashtëshe ishte edhe Nora me Gjylin. Drejtori, unë dhe ato tē dyja flinim nē shkollë nē dy nga dhomat që nuk ishin zënë ende deri atëherë. Dhomat ishin nē skaje tē kundërta. Ato i kishte caktuar vetë drejtori, sepse «nuk kishte aspak qejf tē dëgjonte fjalë».

Dielli po bënte harkun e tij tē përditshëm drejt perëndimit kur u nisa pér nē Kodras me Norën. Ishte bërë traditë e mirë që një herg nē muaj tē shkonim nëpër fshatra pér tē njojur prindërit e nxënësve me punën tonë, me arritjet dhe tē metat e kësaj pune, gjithashtu tē nji-heshim edhe me ndonjë hall tē prindërve pér shkollën e fëmijët.

Takimi me prindërit u bë nē vatrën e kul-turës. Zgjati më tepër nga q'mendonim ne. Pás

takimit na u lutën të flnim në shtëpitë e tyre. U thashë se do të nisësha që atë çast, pasi më rëndonte shumë ngritja herët në mëngjes. Po kështu tha edhe Nora. Kundërshtimi i saj shkaktoi habi, sidomos te disa gra.

Pa dalë mirë nga fshati, iu luta Norës që të rrinte, pasi udhëtimi natën për të do të ishte i vështirë, gati një orë rrugë.

— Kam shumë dëshirë të udhëtoj në një natë me hënë si kjo, — tha gati si fëmijë e lumtur. Kam udhëtar vetëm një herë, kur isha e vogël. Atëherë zbritja nga fshati më nënën. S'di pse ajo natë më ka mbetur në mendje si diçka shumë e bukur. Ty, Dimo, të pëlqen nata me hënë?

— Shumë!

— Edhe mua!

Hëna copëtohej nëpër gjethet e rralluara të drurëve. Një zog, të cilat ne i themi gjon, këndonte shumë trashë diku, në thellësi të pyllit.

Nora ecte pas meje, pas rruga ishte e ngushtë dhe nuk na merrte të dy njëherësh. Këpucët i kishte me takë pak të larta dhe shpeshherë pengohej në ndonjë gur.

Pastaj rruga u fut përmes një lëndine dhe Nora tha që të rrnim pak për të soditur hënën. Zogu me emrin «gjon» këndonte fare pranë.

— Ky zog nuk më pëlqen fare, — tha Nora apo u ulëm. — Këndon sikur gjuan me çekan.

— Ashtu e ka stilin, — qesha unë.

— Ç'them edhe unë, se mos është në dorë të tij, — qeshi dhe ajo.

Rrinim ulur në lëndinë. Rruga kalonte përmes saj si një tegel qëndisjeje. S'di pse lëndina e vogël, mbi të cilën ishim ulur, më ngjasoi me një përparëse ose pecetë shtruar në prehrin e

pyllit. Ia thashë këtë Norës. Ajo më vështroi me bisht të syrit dhe buzëqeshi.

— Nuk të dija kaq romantik, — tha.

— Do të më bësh qejfin, — thashë. M'u pengua pak frymëmarrja.

— Sa hënë e bukur! — ndërroi bisedë ajo.

— Shumë e bukur! — thashë dhe i hodha dorën mbi sup.

— Nuk mund të thoshe «shumë e bukur» pa ma hedhur dorën? — pyeti me zgjuarsi. Ndjeva të më nxehet fytyrë e të më pritej krahu. Me vështirësi hoqa dorën nga supi i saj. U hutova Nora po lumi turohej pas hënës, copëtimi i së cilës kishte marrë fund. Ajo i kishte mbledhur copëzat e saj dhe kishte dalë mbi kokat tona plot pesëmbëdhjetëshe. Hënë me të vërtetë e bukur. Trupi i saj pa jetë, i verdhë, dukej si një fytyrë e habitur.

— C'mrekulli! — ia bëri Nora dhe u mbështet mbrapa mbi bërryla. Pranë meje, fare pranë, frymëmarrja e saj e rregullt. Frymëmarja ime pengohej pak! Pse kështu?

— Nuk ke frikë, Nora? — pyeta pa e kontrolluar veten. Më erdhi turp në çast, por ishte tepër vonë.

Ajo u ngrit përgjysmë dhe më vështroi nësy.

— Aspak, — tha e sigurt, — pse e bëre këtë pyetje?

— As vetë nuk e di pse e bëra, — thashë pak nervoz.

Ra heshtja. Fare pranë meje frymëmarrja e rregullt e saj.

— Tani natën të mbushet mendja plotësisht në pafundësinë e gjithësisë.

Foli ajo. M'u duk se zëri doli nga thellësia

e pyllit si një fëshfërimë. Zë i qetë, paqësor, i pathyer. U drodha pak.

— Por vetëm në një vend të qetë si ky, — thashë.

Ajo ktheu kokën nga unë.

— E ke vënë re dhe ti këtë, Dimo?!

— Disa herë!

— Sa mirë! Për mua kjo është hera e dytë. Ndoshtha krijohen të tjera raste.

— S'dihet! — thashë.

Ajo qeshi pak, por fare papritur u bë e heshtur, sikur donte të kujtohej për diçka.

— Ti qesh shumë bukur, Nora! — thashë pas pak. Tani them të ikim. Dua që të lëmë këtu jehonën e së qeshurës sate.

Ajo u kthyte plotësisht nga unë dhe më vështroi drejt në sy.

— Si të duash! — tha dhe u ngrit.

Ecëm disa minuta pa folur. Mbrapa, në thellësi të pyllit, lamë zogun me emrin gjon që «gjuante me çekan».

— U bënë dy net të bukura me hënë që nuk do t'i harroj, — tha Nora. Ecje përpëra. Unë ecja pas saj. Pengohej më pak nëpër gurë. Krahët gjatë ecjes i mbante pak hapur.

— Shkruaji, që të mos i harrosh, — thashë.

Ajo ktheu kokën një çast nga unë.

— Mban ditar tij, Dimo? — pyeti.

— Mbaj! — thashë e s'di pse qesha.

— Sa mirë! Është shumë mirë të mbash ditar. Unë do të filloj që sonte të mbaj ditar.

— Po mos i shëno të gjitha në të! — qesha.

Ajo u kthyte rrëmbimthi nga unë.

— Pse?! — pyeti e habitur.

Qesha me zë,

— Sepse nuk dihet ç'burë merr dhe...

Ajo më vështroi pak gjatë në sy.

— Sa i lig bëhesh!

Përsëri heshtje. Pyllin e lamë mbrapa. Zogu nuk dëgjohej më. Drurët ishin zëvendësuar nga shkurret, që herë-herë dukeshin si hije që përgjonin.

Iu afroam pa kuptuar shkollës. Nga zyra e drejtorit dilte një shtizë e stërgjatur drite, që kryqëzohej diku larg me shtiza të tjera dritash. Vetëm zyra e tij kishte dritë. Ndoshta drejtori ishte duke plotësuar ndonjë formular, nga ata që i kërkon shpeshherë seksioni.

Trokita në derë dhe hymë të dy me Norën. Drejtori ngriti kokën dhe gati ngriu në një qëndrim të çuditshëm.

— Tani erdhët?! — pyeti. Zëri i tij kishte shumë habi.

— Sapo! — thashë unë dhe hapa krahët.

— Sapo, apo?! — Drejtori po ngrinte më tepër.

— Sapo arritëm, — thashë përsëri.

— Direkt?!

Pas meje Nora queshte me zë.

— Nga fshati, rrugës dhe... këtu, — shpjegova.

Drejtori shkriu pak. Mënjanoi më tepër kokën dhe vështroi nga Nora.

— Ju, Nora, natyrisht, keni ardhur më parë. Desha të them se Dimon e takuat këtu, tani... këtë çast, — u ngut ai, ndërsa një nerv i lëvizte nervoz poshtë grykës.

Nora vuri pëllëmbën para gojës. Nuk foli. Drejtori priste me vështrimin mbi të.

— Tani apo erdhi dhe ajo, me mua, — fola unë në vend të saj.

Drejtori na vështroi veç e veç (Norës i shi-

konte vetëm gjysmën e trupit), dhe lëvizi kokën me mëdyshje.

— Mirë, mirë! — tha duke luajtur kokën majtas e djathtas, — shkoni!

Thamë natën e mirë dhe dolëm.

— Edhe ti, Dimo, dole?! — u dëgjua nga mbrapa zëri i drejtorit.

U ktheva deri te dera.

— Jam i lodhur! — thashë dhe ika.

M'u duk se drejtori tha: «Kaq i lodhur qenke?!» po, ngaqë nuk isha i sigurt në tha pikërisht ashtu, nuk u ktheva për t'i treguar atij afërsisht masën e lodhjes.

Nora tha me zë të ulët: «I lezetshëm!» dhe ne u ndamë për në dhomat e fjetjes.

Të nesërmen pasdite drejtori më thirri në zyre. Më tregoi me stilograf një karrige përballëtij dhe unë u ula.

— Ç'kemi? — pyeti shkurt, ndërsa nxirrte nga sirtari një fletore.

Unë ngrita supet për të thënë se nuk kisha gjë.

— Si, nuk ke gjë?! — pyeti pak nervoz.

Unë ngrita përsëri supet. Drejtori ia bëri «ç...ç» dhe hapi fletoren.

— Mbete duke ngritur supet, a derëbardhë, — tha dhe më nguli vështrimin në sy. Duart i mbante të përthyera mbi fletoren e hapur, ndërsa me gishta herë hiqte dhe herë vinte kapakun e stilografit.

Unë ngrita edhe një herë supet, por jo për t'i thënë atij se nuk kisha gjë. As vetë nuk e di pse i ngrita supet. Ndoshfa një veprim i tillë më ishte bërë zakon kohët e fundit dhe unë nuk e kisha vënë re. Por... do ta shikoja mirë këtë veprim. Që të nesërmen. Drejtori ia bëri përsëri

«ç...ç» dhe qeshi si ata që duan të thonë: «Ti s'di se ç'bën!»

— Po mbushen gati njëzet e katër orë nga koha e kryerjes së detyrës që t'u ngarkua dhe nuk po vjen të raportosh, — tha me zërin midis qortimit dhe ironisë. Vështrimin yazhdonte ta mbante në fytyrën time. Vura re se i lëvizi një nerv në qerpik.

— Ah, po, — ia bëra, si i zënë ngushtë, — nuk e kisha harruar. Do t'ju raportoja pas gjysmë ore. Kisha diçka në duar, që duhej ta mbaroja sa më shpejt.

Ai qeshi si për të më thënë: «Nuk ma hedh dot mua ti, shko gjej ndonjë tjetër!»

— Ashtu, Dimo, hë, do të vije pas gjysmë ore! I shkathët je, Dimo. Nejse, njeriu duhet të jetë pak i shkathët, se, edhe qull fare, bëhet bajat, — tha pastaj me zë dhe heshti pak, duke më hetuar si pa qëllim. — Ah, more Dimo, janë disa gjëra në jetë, që, edhe të duash ti t'i lësh, nuk të lënë ato, — shtoi e psherëtiu lehtë. — I thonë punë shteti, more vëlla, nuk i thonë lojë fëmijësh. Ja, ta zëmë se nuk e kërkova unë zbatimin e detyrës. Vjen një tjetër nga baza, nga fshati, desha të them për rastin tonë konkret, dhe thotë: «Ore, ç'bëtë me ato problemet që dolën nga mbledhja?» Jam i bindur se ti nuk e di sa ngushtë ndodhesh. Mua më ka ndodhur herë tjetër dhe këto gjëra i di mirë. Disa herë, dhe kjo ka ndodhur edhe për ty, e myllim njërin sy e njërin vesh, po disa herë, ëhë... gjë që s'bëhet. Ja, Dimo, të ishe ti në vendin tim, domethënë të ishe ti drejtor, thuaj të drejtën, ç'do t'i thoshe atij të bazës, po të mos dije se ç'ishte bërë?

Mora frymë thellë.

— Prit, prit, mendohu pak. Vetëm të thuash të drejtën, ama, siç ta thashë dhe unë, ç'do të bëje?!

— Do t'i thosha, shoku drejtor...

Ai më kapi nga krahu me pamjen e një njeriu të fyter rëndë.

— Do t'i thosha, — përsërita edhe një herë, — atij të bazës që... — heshta pak, jo pa qëllim. Drejtori qeshi i kënaqur, ndoshta ngaqë unë po ndodhesha ngushtë. — Pra, do t'i thosha atij të bazës që... — heshta përsëri me qëllim. Drejtori ndehu qafën. — Që t'i binte shkurt, dome-thënë... — përsëri heshta me qëllim. Drejtori e tërroqi qafën. — Domethënë të ma thoshte hapur atë që donte të më thoshte.

Drejtori ngriti me majën e gishtave një furçë flokësh që i kishin rënë deri mbi vetull. Kisha vënë re se, sa herë kryente atë veprim, diçka bluante përbrenda.

— E ç'deshe të thuash me këto fjalë?! — pyeti me ton habie dhe nervoz njëkohësisht. Furça e flokëve i kishte zbritur përsëri deri te vetullat («Dale, ç'bëni ju, motrat e mia?!» dukej sikur thoshte furça e flokëve), dhe ai e ngriti përsëri me majat e gishtave.

— Desha të them, shoku drejtor, — thashë, pa pasur hall se po e fyeja, duke iu drejtar me fjalën drejtor, — që edhe ju ta kërkoni shkurt atë që doni nga unë.

E vështroja drejt në sy. Edhe ai më vështroi një çast drejt në sy. Vetëm një çast. Pa-staj e uli vështrimin mbi xhamin e tavolinës. Mori frymë thellë, psherëtiu, qeshi dhe ngriti kokën.

— Mirë, o Dimo, mirë. Ti ke mendimin tënd. E shoh që më keqkuptove, por nuk ka gjë. Ti

vjen rrallë këtu, vetëm kur të thërres unë. Bëjmë ndonjë çikëz muhabet, me këtë rast, thashë, se, gjithmonë me zyrtarizma, mërzitesh. Ti me këmbët e para. Ti bie shkurt, thua. Ë pse, ore, nuk ka të drejtë drejtori të bëjë muhabet, të qajë hallet me vartësit? Nejse, ke të drejtë, se nuk je ti drejtor. Më valon mua koka, nuk të valon ty. Mirë, meqë nuk ke qejf të bëjmë muhabet, po i bie shkurt: Na thuaj, ç'probleme dolën andej nga baza? — Ia bëri «ç...ç» dhe mori frymë thellë.

U pendova për fjalët që i thashë. Filloi të më vinte inat me veten. Ndoshta ai nuk kishte ndonjë qëllim të keq. Pse reagova ashtu? Pse?

— Më lejoni të shkoj në dhomë për të marrë fletoren e shënimeve, — thashë. Ai bëri «po» me kokë dhe unë dola.

U ktheva pas dy minutash. Hapa fletoren dhe ia lexova të gjitha ç'kisha shkruar në të: problemet, mendimet, detyrat për të ardhmen. Prita sa mbaroi ai së shkruari.

Drejtori ngriti kokën dhe më vështroi në sy, si ata që presin t'u hedhësh diçka më tepër. Unë e kisha mbyllur fletoren time.

— Kaq ke?! — pyeti.

— Kaq!

Ai ndehu qafën përpara.

Si kaq??

Qesha.

— Domethënë nuk kam të tiera për të thënë. Tani na duhet që detyrat t'i ndjekim hap pas hapi, të mos na mbeten në letër.

Ai u tërroq pak mbrapa dhe u mbështet në shpinën e karriges.

— Domethënë nuk ke më!

Më vështroi gjatë në sy. Furça e flokëve i

zbriti përsëri deri te vetullat (dale, c'bëni ju, motrat e mia?!), por ai nuk i ngriti lart.

— As shoqërore?! — pyeti pas pak.

Unë ngrita supet.

— Si «as shoqërore?!» — i thashë.

Ai u shkëput nga karrigia dhe mbështeti bërrylat mbi tavolinë, ose më saktë mbi xhamin e trashë të vendosur mbi tavolinë.

— Desha të them se janë disa gjëra që nuk shkruhen në fletore, — tha drejtori, duke iu penguar pak zëri. Lëpiu një çast buzët me majën e gjuhës dhe kapërceu pështymë. Vura re se i lëvizi disa herë diftaku poshtë grykës.

Dicka kuptova. Dëshiroja të kisha gabuar, po ndjeva të më nxehet trupi. Nxehësia ngjitej nga poshtë lart dhe u mblodh në kokë. Filluan të më rrithnin fort tëmthat. Bam-bam! He, do ndonjë gjë shoqërore ti, hë?! Po pse, more beqar i vonuar, c'pandeh ti?! C'kërkon nga unë ti? C'janë këto që mendon zotrote??!

Mbylla përgjysmë sytë, siç bëj shpeshherë kur nxehem, dhe u mbështeta në shpinë të karriges. Krahët nuk i lëshova poshtë. I lidha mbi gjoks. Drejtori priste me vështrim mbi mua. Me vështrim të shuar.

Mora frymë thellë. Gjoksi m'u ngrit përpjetë me gjithë duart.

— Më vjen shumë keq, shoku drejtor, — fola, duke u përmbajtur me vështirësi. — por unë e di se nuk ka asgjë shoqërore që të mos lidhet në njëfarë mënyre me shtetëoren!

Ai qeshi, uli një çast kokën, puliti sytë, ngriti furçën e flokëve, që i kishte rënë deri te vetullat (c'keni kështu, motrat e mia?!), dhe ngriti kokën përsëri. Fytvra: e verdhë.

— Djalli vetë je, Dimo, — tha me zë të butë.

— Ke të drejtë. Ke veçanërisht të drejtë. Po më mbushet mendja çdo ditë e më tepër se kam bërrë shumë mirë që kam thënë pér ty fjalët më të mira kur ka qenë rasti. — Ai qeshi, sikur me atë të qeshur donte të thoshte: «Si e humba kësh-  
tu?!» — Eh, mor Dimo! Mund të formulohet ndryshe, dreqi, por u ngatërrova dhe thashë fjalën... he... dreq o punë... shoqërore. — Qeshi përsëri.

He he! Nuk kisha gabuar në dyshimin tim. Kërkonte t'i tregoja ndonjë gjë intime! Bukur fort, o drejtor! Mrekulli, o beqar i vonuar, por ke ngatëruar derë. Ke trokitur në derë të shurdhit, megjithëse unë, shurdhi, nuk kam ndonjë gjë intime pér të të thënë, nga ato «intimet» që do ti. Mora përsëri frymë thellë. Përsëri gjoksi u ngrit dukshëm lart, me gjithë duart e mbështetura mbi të. Qesha.

— Intime?! — pyeta. Ai bëri «po» me kokë e me buzëqeshje. — Jo! — shtova. Ai ktheu kokën përpara pér të dëgjuar më mirë. Buzëqeshja i ngriu. Asgjë intime nuk kam pér të të thënë, — vazhdova me ton të qetë, por edhe pak shpotitës. Në fund: një buzëqeshje. Me zë kjo do të zëvendësohej: e mbyllim edhe këtë kapitull?

Drejtori uli përsëri kokën. Ngriti edhe një herë furçën e flokëve që i kishte rënë deri te vetullat (ç'bëni kështu, motrat e mia, që po ule ni e po ngriheni vazhdimisht?!), dhe qeshi. Fytyra: herë e kuqe, herë e verdhë. Më shumë e verdhë.

— Mirë, Dimo, mirë. Pyeta kot, të më besosh. Punë pér ty. T'i lëmë këto tanë e të flasim pér punën, se kjo punë na jep bukë...

— Jo vetëm bukë, shoku drejtor, — e ndërpreva qëllimisht.

— E, mo, mirë, a derëbardhë, — tha duke qeshur, — mos m'i vër re, se jam pak i hutuar sot. Në relacionin e këtij muaji, që po e bëj gati përtatë dërguar në rrëth, lëndët e tua kanë përqindjen më të ulët... Këtu desha të dilja pak më parë, po ti...

— E di! — e ndërpreva përsëri me qëllim. se e mora vesh ku donte të dilte.

— Po prit, or dreq, të mbaroj unë njëherë, — tha me ton të shtirur dashamriës. — Edhe notën mesatare e ke më të ulët se mesatarja e rrëth...

— Edhe këtë e di, shoku drejtor.

— Nuk dyshoj. E di që ti e di, sepse vetë m'i dhe përfundimet e muajit, — ai heshti një çast, më nguli vështrimin në fytyrë, qeshi dhe shtoi: — Ti e di, Dimo! Unë nuk kam aspak dëshirë të dëgjoj fjalë. Tani, xhanëm, fjalë do të dëgjojmë, se, si thoni ju të gjuhës, fjalë i shpreh mendimet, po mirë do të jetë të dëgjoj fjalët e tua. Të dëgjoj nga të tjerët, ndryshon puna. Sado që të dua... sado që... detyra mbi të gjitha. — Ngriti supet, mbështeti pëllëmbët mbi xhamin e tavolinës dhe u ngrit.

Sytë drejt fytyrës sime. Vështrimi ende i shuar. Vështrimi i tij donte të thoshte: Bashkë mbaruam. Desha të të ndihmoja, por ti je kokëshkëmb. Nuk do ndihmë. S'kam ç'bëj më tepër.

Mbaroi ai, por nuk kisha mbaruar unë. I bëra shenjë që të mos dilte. Qëndroi me dorën te doreza e derës dhe më vështroi i habitur. Mos i rilindën shpresat se mund t'i thosha ndonjë gjë intime? He, shfryva me hundë, e me mend blo-

va këtë mendim: Sa mirë ditke të bësh presion, ore drejtor! Po sikur të të kisha thënë nga ato «intimet», që do ti, ç'do të bëje? A do të ma përmendje notën mesatare? Po përqindjen? Të gjitha këto pyetje më vërvshuan në kokë atë çast, kur ai rrinte më këmbë, me dorën e djathtë te doreza e derës.

— E ngjeshi më fort derën, lëshoi dorezën dhe më qëndroi përballë.

— Deshe të thuash gjë? Thuaje, se kam punë! — tha me ton mëdyshës.

— Po, shoku drejtor, desha të them diçka shoqërore, — fola jo pa ndier njëfarë tronditjeje,

— Shoqërore?! — u habit më tepër ai.

— Po, shoqërore!

Ai ngriti supet.

— E po... thuaje...

— Këtë që bëre sot, mos e bëj herë tjetër, shoku drejtor. Këto... që thamë këtë radhë, i lëmë midis nesh. Tani hape derën. Dua të dal, — thashë ashpër.

Ai shkoi përsëri te dera, mbështeti në të gjithë trupin dhe qëndroi me fytyrë nga unë. Qeshi.

— Unë jam drejtues në këtë shkollë dhe Partia më ka mësuar të jem zemërgjerë. Ki kujdes, djalë! Ule hundën! — Më goditi lehtë me majat e gishtave në shpatulla. — Atij shokut që zëvendësove, hunda ia hëngri kokën. Unë nuk kam aspak dëshirë të dëgjoj fjalë. Ti... Nejse, dil. Mirupafshim! — Hapi derën.

Nuk mbaja mend të isha habitur ndonjëherë në jetën time njëzeteshtatëvjeçare, sa u habita atë ditë. Shqiptova «mirupafshim!» dhe dola.

## Radha e bukës

Ato ishin të dyja plaka. Kishin thuajse të njëtin trup. Ecnin ngadalë dhe mendonin njëhoj. Bashkë kishin ardhur nuse në fshat, hipo mbi kalë të bardhë. Gati në një kohë kishin lindur fëmijë. Bashkë shkonin nëpër dasma, nisin çupat nuse ditën e enje dhe u këndonin djemve-dhëndurë. Bashkë shkonin në varriime, qanin me kujë për njerëzit e dashur dhe shkërmognin me gishta të dridhur baltën e butë mbi tabutin e sapofutur në dhë. Bashkë kishin luttuar për të shtyrë tutje vdekjen e shpirtit të tyre dhe të shpirtit të të tjerëve. Bashkë kishin pritur mbi duart e rreshkura jetë nga jeta e nuseve, që lindnin për herë të parë. Bashkë...

Bashkë kishin shkuar dhe atë ditë për të mbledhur bukën. Oh, buka! Mos ua kujtoni vuajtjet për bukën.

Kishin bërë ca rrugë dhe ishin lodhur. Kishin dëgjuar kërcinjtë si u anko heshin dhe ishin ulur.

Dhe kishin ndenjur ashtu një çast pa folur. I thërriste rruga e gjatë, e gjatë. I thërritnin njerezit e dashur, që rrinin në dhé, me një pllakë guri te koka. I thërritnin hallet. Sepse ato ishin gatuar me halle. Vetëm njeriu që do të qelbet në vend nuk e kërkon hallin, nuk e kërkon punën. Oh, ato ishin të dyja plaka dhe e donin shumë punën. Ato... Njëra quhej Sofi. Tjetra quhej Nake.

— E di ti, Sofi, ç'them ndonjëherë me mend, kur ndodhem vetëm? — thotë Nakja. Dhe vështron nga Sofia sikur vështron nga vetja. Se ato janë gati njëlloj.

— Pa hë, o Nake, se ti rri sa rri dhe nxjerr ndonjë xhevahir, — thotë Sofia dhe vështron nga shoqja sikur vështron nga vetja.

— Them, o Sofi, se ne kemi një të keqe...

— Të keqe?! Ç'nuk të thotë mendja ty, Nake! Pa hë, ç'na qenka kjo e keqe? — Fytyra e Sofisë mbushet me rrudha. Rrudhat u ngajnjë rrëkeve që zbresin nëpër rrëpira. Asnjë të keqe nuk kemi ne, thotë me mend. Thotë kështu dhe pret. Dhe shikon në fytyrë Naken. Po Nakja nuk flet. Sofia seç ndien në gjoks. Gëzim? Ajo nuk e di mirë as vetë se ç'ndien në gjoks. Megjithatë mendon: «E sheh, që nuk kemi asnjë të keqe?!» Po nuk e ka mbaruar mirë këtë mendim, kur sytë shohin buzët e shoqes që lëvizin pak. Hë?

— Po ja, kemi të keqen që jemi plaka. Të ishim më të reja, ndryshe do të qe puna. — Nakja flet me dhimbje. Ç'thotë kështu Nakja?! Ajo nuk e ka kujtar kurrë pleqërinë. Ç'iu kujtua taní?

— Hë, se të reja jemi, o Nake, mos u qaj! Derisa na lëvizin këmbët, derisa na shpërndan

zemra gjak, të reja jemi, — thotë Sofia, jo pa dhimbje edhe ajo dhe vë pëllëmbën mbi kraharor, në anën e majtë. Nuk ndihet fare, qyqarja, mendon për zemrën. Edhe mirë, ç'të ndihet, me tërë ato rroba që i kam hedhur unë përsipër.

— Po, xhanëm, o Sofi, të reja jemi akoma, po sesi më erdhi kur ai i byrosë na tha: «Ju plakat shkoni në shtëpi tanë, se u lodhët.»

— E po atë detyrë ka ai, o Nake, prandaj është i byrosë. E di ai që ne jemi të themelit dhe do që të mos lodhemi shumë. Po ne kot nuk i thamë të punonim akoma.

— Po ndoshta mjaft punuam! — përpinqet të qetësohet Nakja.

Sofia hesht një çast. Mëndohet. I trazohen rrudhat nëpër fytyrë. Ç'hotë kështu Nakja?! Do të jetë lodhur.

— Jo, o Nake, jo! Për këtë Parti e për këtë qeveri nuk duhet thënë kurrë «mjaft punuam!»

— Zëri i Sofisë dridhet pak. Ç'ka Sofia?

— Se mos thashë ndonjë të keqe unë, o Sofi! Pastaj, edhe ti ke faj. Pse pranove të iknim? Sikur nă qanin kalamajtë.

— U ndodha bosh, o Nake. Iku ajo punë tanë. Por edhe ai i byrosë sesi na e tha. Më erdhi zor t'ia bëja fjalën dy.

— Hë, se nuk mbaruan ditët, jo. Shkojmë përditë, derisa të mbarohet misri.

Sofia vështron qiellin. Ai është i mbuluar me re dhe sikur ndien të ftohtë.

— Ishalla nuk bie shi, — thotë sikur lutet.

— Nuk bie shi, jo, — thotë Nakja. Ajo thotë dëshirën e vet.

Ngrihet Sofia. Ngrihet edhe Nakja. Ecin ngadalë, ngadalë.

Hyjnë në pasarelë. Ajo pothuajse nuk luan

fare nën peshën e trupit të tyre. Vetëm rrallë, fare rrallë lëshon si pa qejf ndonjë cëf-cëf të dobët, sikur tallet.

— Hiç nuk luan, gërmadha, o Nake! — i dridhet zëri Sofisë. — Hajde, ç'bëhej atëherë me ne, o Nake, ç'bëhej! Më kujtohet njëherë, kur isha nuse e re, duhet ta mbash mend edhe ti, sapo më kishte marrë Coli. Kaluam të dy ngarkuar me misër mbi këtë pasarelë. Ishte dhe natë, pale. Tundej kjo, të thoshe t'i se do të kë-putej. Më mbante Coli i shkretë nga duart, po mua sesi më vinte dhe tundesha më shumë. Mezi e kishim gjetur atë misër, me njëqind e pësëdhjetë lekë kilen, tek ai qafëthyeri. Ja, kështu kjo. Tani nuk do t'ia dijë fare nga ne, na marrtë të keqen, na marrtë!

Nakja hesht. Hesht gjatë. Kanë kaluar pasarelën mbi lumë dhe kanë lënë mbrapa cëf-cëfet e saj, si finguj që u kujtojnë një botë tjetër. Ecin truppërkulur. Ngadalë, ngadalë.

— Mua më kërcasin gjunjët, Sofi. Ulemi?

— Ulemi, Nake. Edhe mua më kërcasin gjunjët.

Vështrojnë lart, në qìell. Dielli përpëlitet në pelenat e reve sikur i është zënë fryma. Vrenjitet fytyra e Nakes. Psherëtin zemra e Sofisë.

— Ah, sikur të mos bjerë shi për një javë! — thotë Nakja. Zëri i saj ka dhimbje, ka dëshirë, ka vuajtje, ka edhe gëzim...

Sofia hesht. E zuri gjumi, mendon për të Nakja.

— Të zuri gjumi? — i thotë me zë.

Sofia pulit qerpikët. I fërkon pak me mollëzat e gishtave dhe thotë:

— Jo, po mendohesha.

— Ç'mendoje?

— A tē kujtohet ajo ditē kur zumë radhë pér bukë te prefektura, o Nake?

Nakja mendohet pak. Gérmon hellë nē kujtesë. Ku nuk i shkon mendja kësaj Sofisë, mendon.

— Ku nuk tē fluturon mendja ty, o Sofi. Si atëherë kur ishe nuse e re. Hajde, si ishe atëherë ti, si ishe! E, nejse, më kujtohet, pastaj? — ngatérrohet Nakja.

Sofia, që me zor i ka përbajtur kujtimet, vazhdon:

— Hajde, ku erdhëm, hajde! Na thanë se atë ditë do tē ndanin bukë. Këmbëve unë me Colin dhe shkuam. Rruga plot me italianë. E mbaj mend si sot. Isha edhe me barrë më Spiron atëherë. Ti erdhe më vonë se ne. Atëherë ti ishe me barrë më Lenën. Të kujtohet? E, që ta pata fjalën, zumë radhë pér tē marrë bukë. Prit e s'ka, prit e s'ka. Më nē fund doli ai trashaluqi, me ca s'y tē fryrë, me faqet tē varura poshtë, si queskat që mbanim ne nē duar. me hundë tē vockël, tē vockël, si krimb. Uf, si ishte ai! Edhe sot, kur e kujtoj, më kall datën. Të kujtohet?

— Ua, korbë, si s'më kujtohet??

— E kur thanë pastaj që gratë me barrë tē dalin nē krye se do tē marrin bukë tē parat, shtrëngova fort Colin unë dhe nuk lëviza. Pale ç'mund tē bënин me ne ata. Kurse ti dole që nē fillim. Të lumtë ty, nuk pyete fare!

— Nuk pyeta fare unë!

— E, që ta kam fjalën, dola edhe unë, e mbaj mend si sot, barkun te goja. Ama, dridhesha si purtekë, s'të gënjej! Ç'kemi hequr ne, ç'kemi hequr! U bëmë nja tetë gra me barrë që zumë radhë tē parat. Trëng, ma bënte ze-

mra. Ktheva kokën pas e pashë burrin. Edhe ai po më vështronët mua. Sikur m'u qetësua zemra. Ndryshtë është kur ke burrin pranë. Më dëgjon?

— Ehë, të dëgjoj!

— Pastaj, ai trashaluqi me atë hundën si krimbi dha urdhër të na kontrollonin me duar të gjitha, se mos kishim futur gjë poshtë fustaneve për t'u dukur me barrë. M'u err dhieu kur e dëgjova. U afroa xhandari me trashaluqin për të na kontrolluar. Të kontrolluan ty?

— Jo, nuk arritën dot, se u lëshuan burrat dhe desh u bë kasaphanë.

— Mirë thua! E shikon që e mbake mend mirë dhe ti?!

— Ua, pse, ç'jam unë?!

Sofia humb për një çast nëpër shtresat e kujtimeve. Pastaj lëshon një «ë» fare kot dhe vazhdon:

— Doli ai trashaluqi mbi avlli, i bëre xhind, dhe tha se nuk do të na jepnin bukë, për fajin tonë. I pëlgente atij barku ynë. Por, me soj e me xhins të shuheshim, atë që donte ai nuk e hanim ne. Pastaj trashaluqi dha urdhër të largoheshim. U bë një rrëmuje, pastaj, që... pale si do t'i kishte vajtur filli, po të mos kishte dalë ai djali mbi avllinë tjetër. Vëlezër dhe m'otra..., tha ai, hë? Apo kishe ikur ti atëherë?

— Jo, nuk kisha ikur!

— E, mirë thua, nuk kishe ikur. Ku e lashë? Hë, m'u kujtua! «Buka ju takon, se është juaja. Asnjë të mos largohet prej këtej pa bukë. Në qoftë se nuk duan të na e japid, do t'ua shqy-ejmë vetë depot, se këta gjarpërinj ia japid bukën më parë armikut sesa neve. Armiku na ka shkelur vatanin dhe nuk do bukën, por plu-

mbin tonë.» Po si fliste, i uruari! Pale ç'sy kishte! Faqet dhe buzët qumësht. Apo ç'i kishte lezet fjala! Pastaj ai xhandari u inatos dhe e qëlloi me pushkë. È vrau apo jo, Nake?

— Ua, korbë, harrove ti?! Ai na erdhi në fshat pas ca ditësh për të bërë një mbledhje.

Sofia hutohet pak. I ngatërrohen pak shtresat e kujtimeve, siç ngatërrohen në pyll shtresat e gjetheve nga hapat e rrëmbyer të një udhëtarë.

— Jo, — thotë me mëdyshje.

— Erdhi, korbë, erdhi, e mbaj mend mirë unë.

— Nuk ma merr mendja të ketë ardhur, o Nake!

— Erdhi, o Sofi, erdhi, por nuk ndjenji për ëdarkë, se kishte punë të tjera.

Sofia hutohet keq. Megjithatë gërmont edhe pak në kujtesë dhe pyet:

— Po unë ku isha atëherë?

— Ti ishe më të parë, në derë babai.

— U, ee, mirë thua, Nake. Të lumtë! Tani po. Duhet të ketë ardhur, po si e pritet ju?

— Të thashë që nuk ndenji, se kishte punë të tjera.

— E, o Nake, për atë ditë të zezë, erdhëm në shtëpi me duar bosh. Një duziqë fëmijë në vatër. Me atë të ngrënë, me atë lodhje, pas një javë bëra Spiron unë. Ti e bëre një javë më vonë Lenën. Ngrehu tani. Shiko, po flenë zogjtë!

Ngrihen. Ecin ngadalë. Sikur numërojnë vitet. Janë të dyja plaka. Ecin ngadalë dhe menjnë njëlloj. Këmbët u janë mpirë pak. Megjithatë ecin. Pastaj i shpejtojnë pak hapat. Shporru, pleqëri!

Hyjnë në fshat. Dritat e rrugëve ende nuk

janë ndezur. Nëpër gëmusha futen me rrëmujë zogj që duan të flenë. Diku leh një qen. Një këndes diçka i thotë shokut që ka hipur mbi një gardh. Një zë mallkon pulat që nuk mbli-dhen në kotec. Muzgu i mbrëmjes griset tek-tuk nga ndonjë shtizë e hollë drite që del nga drif-tare shtëpish.

— Atë ecin. Shohin derën e dyqanit të bukës që rri hapur.

— Marrim dhe bukën, pa shkojmë në shtëpi?

— Mirë thua. E marrim.

Dhe ecin. Ecin ngadalë, ndërsa në hundë ndiejnë aromën e dashur të bukës së ngrohtë. «Ah, sikur të mos bjerë shi për një javë!»

## Sedra

Mbrëmja u afroa ngadalë si një njeri që kërkon të trembë dikë. Ai e vuri re zbritjen e saj pikërisht kur drita që hynte nga dritarja ia lëdhte sytë dhe ia bënte të pamundur punën mbi letër. Ishte tamam buzëmbërëmje dhe dëshira e tij ishte që ato çaste të ndodhej jashtë, nëpër arë, të kundronte zbritjen e saj gati tinëzare, të ndiente me të gjithë trupin fërfëritjen e ajrit, rrëshqitjen e lehtë të rrezeve të fundit të diellit nga maja e maleve. Dhe i erdhë keq që atë natë nuk po ndodhë ashtu. Por, ndërsa ndiente nevojën e ndezjes së dritës elekrike, pati ndjesinë e një boshllëku në trup. Kishte disa vjet që punonte si agronom në atë sektor dhe i kishte ndodhur edhe herë të tjera ashtu, por nuk kishte çarë kokën fare të gjente shkakun e asaj gjendjeje shpirtërore. Ndoshta i dukej atij ashtu, ndoshta kushedi çfarë, por ai mendoi se mund t'i krijohej ajo ndjesi ngaqë kishte ndenjur gjithë ditën në zyrë.

Zyra, e cila shërbente edhe si dhomë fjetjeje, ndodhej në sektorin e dytë të kooperativës, ngjitur me zyrat e tjera. Dera e saj dilte në një korridor të ngushtë, i cili, në disa raste mbe-tej edhe pa u pastruar, sepse ndodhë që normistet të grindeshin një copë herë për radhën e pastrimit dhe, pasi i thoshin njëra-tjetrës: «Ti nuk ma hedh dot mua», e linin pa pastruar, ose pastronin vetëm pjesën para zyrës së tyre. Një fakt i tillë atij i erdhi vetëtimthi në mend, si një vagëllim i pakëndshëm, dhe do të kishte qeshur me tallje, në qoftë se ai veprim ose fakt nuk do t'i kujtonte punën që kishte për të bërë atë natë dhë që ishte çelës zgjidhjeje për punët në ditët që do të pasonin.

Ishte fund tetori dhe mbjellja e grurit ishte në një çast delikat, që të kërkonte çdo ditë e çdo orë te koka dhe atij, si agronom sektori, nuk i falej kurrsesi një harresë ose një nën-vleftësim i tillë. Fara ishte shpërndarë gjatë ditës. Pak keq ishte puna me plehërimin bazë, pa superfosfatin. Ai u kishte ardhur me pakicë (për të sqaruar këtë problem kishte shkuar vetë kryetari te drejtoria e shpërndarjes), por edhe vëtë nuk e kishin çarë kokën si duhej për ta shpërndarë sipas procesit e karakterit të punës, kështu që një pjesë të tij e kishin marrë natën nga togjet. Ambicie brigadierësh. Moti kishte mbajtur shumë mirë deri atëherë; binte disa orë shi e mbante diell tri-katër ditë, sikur shiu me diellin të kishin përfunduar ndonjë marrëveshje të fshehtë atje lart, midis reve. Punë ishte bërë mjaft, sepse secili i kishte ndenjur asaj te koka, por ai nuk mund ta quante kurrsesi të mbaruar. Ishte pikërisht për këtë, që ai ndenji edhe atë natë në zyrën — dhomë për të

hedhur në letër punëa e kryer deri atëherë dhe për të ndjekur nga afër mbjelljen e hektarëve të fundit.

Ende nuk po ngrihej për të ndezur driten e, ndërsa kjo gjë iu bë më e domosdoshme, u kujtua befas se kishte ndenjur më shumë nga ç'duhej mbi ato letra, ndaj vendosi të bënte diçka. Të dilte nëpër parcela, nuk mundte edhe për pak orë, se kishte ende punë me dosjet, ose, si quheshin ndryshe, me evidencat.

Mendoi të hante njëherë. Kuzhinierja atë ditë kishte gatuar vetëm fasule. Iu kujtua se në dollapin e vogël, të ndërtuar me dërrasa, kishte pak djathë e një tufë me çaj mali. Me të mund të kënaqej. Çajnikun e kishte mbushur me ujë. Zjarr në sobë nuk kishte dhe i erdhì keq që ajo punë do t'i hante pak kohë. Mbi tavolinën e punës dhe mbi dysheme kishte paketa të boshatisura, të mbledhura shuk. I mblo-dhi dhe i futi në sobë. Poshtë krevatit mbante drutë dhe ashklat. I futi edhe ato dhe i ndezi. Me kaq e quajti të mbaruar punën për gatimin e darkës dhe shkoi te dollapi, në qoshe të dhomës, ku mbante dosjet. Nuk e hapi menjëherë, madje u tërhoq pak, sikur pikërisht atë çast të ishte penduar e të kishte kthyer mendim. Dhe vërtet ashtu ishte. Sapo ndehu duart drejt dollapit, iu kujtuan fluturimthi traktorët. Iu kujtua, gjithashtu, se puna e tij atë natë lidhej ngushtë me ta. Për vitin e ardhshëm kishin planifikuar rajonizim-specializimin e kulturave, sipas përvojës së disa ekonomive të përparuara. Për këtë ata kishin hedhur njëherësh dy traktore në parcelat përtej lumit, për ta mbjellë sa më shpejt grurin e për t'u ndodhur gati në fushatën e mbjelljes së misrit, në brigadat përkëtej lumit.

Mbarimi i mbjelljes së grurit përtej lumit dhe hedhja e traktorëve në anën tjetër të tij do të bëhej sa më shpejt, se nuk i dihej motit e, me që nuk kishte urë të fortë për kalimin e tyre, vështirësohej hedhja, po që se do të binin shumë reshje.

Përsëri ndjeu njëfarë pendese, ngaqë kishte ndenjur në zyrë e po merrej me dosjet, punë që mund të bëhej në orë të vona, ndërsa atë kohë mund të ndodhej atje ku bëhej puna e gjallë, pa të cilën nuk merrnin frymë kurrë dosjet. Pa punë të gjallë nuk ka dosje, tha me mend dhe i erdhi mirë që ishte ashtu. Prandaj ndjeu edhe njëfarë turpi kur mendoi se ai do të kryente një punë të tillë, ndërsa dikujt i kërkohet të punonte ditë e natë jashtë që ai, agronomi, përgjegjësi i sektorit e ndonjë tjetër, të përkëdhelnin sedrën nga ndonjë lavdërim që mund t'u bëhej për mbjelljen, në kohë e me cilësi të lartë, të grurit.

Edhe një ditë e ndante nga prëmtimi i dhënë. Pas asaj dite traktoret duhej të kishin mbaruar me çdo kusht punë në parcelat përtej lumit dhe duhej të ishin hedhur në parcelat përkëtej tij. Pastaj çdo gjë do të shkonte përbukuri dhe... ndonjëherë... ndonjë ditë (ai filloj të ndiente gudulisje në trup) iks agronom ka... ka punuar mirë, ka vënë int... e përgj... mbi atë pers... Ndjeu përsëri, por më fort, një si gudulisje në trup, sikur dikush e ledhatoi. Atij iu kujtuan raste kur para një mase të madhe njerëzish lavdëroheshin kuadro, madje merrnin dhe dekorata të ndryshme. Pati përshtypjen se dikush i pëshpëriti në vesh për një vend pune më të mirë dhe hapi dollapin. Futi të dyja duart brenda dhe nxori prej andej dosjen ku shënohe-

shin hektarët e mbjellë me grurë. E hapi atë atje ku duhej të shkruheshin të tjera shifra. I kontrolloi mirë kolonat. Shifrat që tregonin sasinë e mbjelljeve ishin hedhur rregullisht në vendet e tyre, me «ha» mbrapa, sikur qeshnin nga gëzimi. «Meqenëse traktorët punojnë, raportoji të mbjella nesër, në mëngjes të gjitha parcelat», i kishte thënë njëri, si me intimitet, pa harruar t'i shkelte pak syrin e majtë. Qeshi me vete. Fare mirë mund të bëhej një gjë e tillë. Jepja normistës (ato, në këtë rast nuk grindeshin siç grindeshin kur pastronin korridorin) dhe ajo: «Alo, komiteti? Mbaroi mbje...» dhe gjithçka mori fund. Përballë, në mes të murit, fleta e nderit me fjalët: «Për punë të...» Iu duk se ndjeu përsëri një dorë në shpatulla, por këtë herë nuk ndjeu ngrohtësi e gudulisje të sedrës, përkundrazi, ndjeu të ftohtë. Gudulisja e parë i kaloi në çjerrje, më keq akoma, në zhvatje gjoksi. Pa punë të gjallë nuk ka dosje, përsëriti me mend, dhe shtoi: Këtë e them me zë të lartë dhe le të mos e miratojë njeri.

U ngrit. Dosjen e la hapur. Shpiu pak krahët dhe e shtyu më tutje. Befas sytë i mbetën mbi një fotografi të vendosur nën xhamin e trashë. Diçka ndjeu në trup, diçka krejt të ndryshme nga ajo që kish ndier më parë. E vështroi gjatë fotografinë. Gruaja qëndronte në mes, ftyrrërumbullake, me mollëzat e faqeve pak të dala, më flökët të lëshuar mbi supe (kjo ishte edhe dëshira e tij), pakëz e menduar, me një deltë rrudhëzash në skajet e buzëve. Iu bë sikur dëgjoi zërin e saj, që i thoshtë: «U bë tërë kjo kohë paardhur në shtëpi...!» Në të dy krahët e saj rrinin vajzat. E madhja kishte ftyrë, të qeshur. Dukej hapur edhe në

fotografi vështrimi çapkën i saj. Vajza e vogël kishte pamjen e një njeriu pak të habitur e të shqetësuar, me një vështrim pyetës. Vajza e madhe i kishte thënë t'i blinte çizme andej nga sektori (pastaj kishte pyetur të ëmën pér kuptimin e fjalës sektor). Nuk duhen çizmet kaq shpejt, moj Migena, i kishte thënë ai, shirat e mëdha bien vonë.

Jo, shi nuk do të bjerë aq shumë, derisa të përfundojë mbjellja e grurit, tha me mend ai, po në brendësi të qenies së vet mendonte edhe të kundërtën, jo se trembej prej tij, po pér t'i paraprirë së keqes. Veçse nuk ishte aspak i kënaqur, sepse deri atë çast vetëm sa kishte menduar. Truri kishte bluar si ata gurët e muillirit, që vijnë rrötull pa pasur drithë midis tyre. Punë kishte bërë më pak, sidomos pasdite. Mos e kishte nga lodhja? Herë-herë mendonte dhe arrinte në përfundimin se kjo ishte thjesht çështje sedre, por, sidoqoftë, arsyetonte ai, kishte diçka të vërtetë dhe e vërteta është kokëfortë. Në mendje iu sulën zënkat e brigadiereve të blegtorisë, që haheshin pér strehimet e bagëtive e të barinjve. Vetëtimthi vështroi nga tavlla e duhanit që ishte mbushur me bishta cigaresh të shtypur e të ngjeshur në lloj-lloj mënyrash. Grindjet kishin ndodhur në zyrën e tij (ajo nuk ishte vetëm e tij), dhe ai kishte pasur rast të jepte edhe ndonjë mendim. Më shumë ishte nervozuar brigadier i tufëzimit të bagëtive të anëtarëve, pasi ai mblidhët ç'linin të tjerrët dhe ankohej se akoma një pjesë e kuadrove i quanin ato bagëti si të tjetërkujt. Ky brigadier, pasi e pinte cigaren, e shtypte fort mbi tavllë bishtin e mbetur, sikur të ndiente njëfarë lehtësimi në vetvete me këtë veprim. Veterineri

vështronte që prapa tymit të duhanit me sy pak të mbyllur. Bishtat e cigareve ky i linte të gjatë dhe i shtypte më nge mbi tavllë. Ai e dinte se të gjitha këto, në fund të fundit, kishin të bënин me atë anë të brendshme të njeriut që quhet sedër. Dhe gjithashtu ai e dinte se sedra është disallojëshe.

Do të ishte marrë ende me kujtime të tillë, shumica e të cilave të bënин për të qeshur, ndërsa një pjesë të ulërije, por iu kujtua shiu dhe hoqi dorë prej tyre.

Pa punë të gjallë s'ka dosje, tha me mend për të disatën herë dhe iu kujtua se gjeti një shkak të asaj topitjeje, të atij hutimi dhe nismën e një veprimi tjetër më të këndshëm. Nuk pyeti më për asgjë. Dritën e la ndezur për të dhënë përshtypjen se ishte në dhomë, kyçi derën dhe doli jashtë. Diku vetëtiu fort dhe ai mbuloi sytë me duar. Pas vetëtimës dëgjoi gjëmimin, që e detyroi të ecte me vrap. Po ku? Ndërsa ecte ia bëri shpeshherë vetes këtë pyetje, derisa diku ngadalësoi hapat për t'u orientuar më mirë. Por pikërisht atë çast kuptoi se traktorët përtej lumit nuk punonin. Hënën, si për inat, e kishin zënë retë dhe ai nuk dallonte asgjë me sy. Sikur të mos mjaftonte kjo, qelli përplasi edhe një gjarpër të zjarrtë diku, duke ofsharë tërë inat. Ai mbuloi përsëri sytë me pëllëmbë dhe iu deshën disa çaste për të marrë vreten.

Më në fund, pasi fërkoi sytë me mollëzat e gishtave, eci drejt pasarelës, që të conte në parcelat përtej lumit, po nuk e ndiiente veten të jetë. E kishte pushtuar të tèrin një tèrbim i pà-pàrmabjatur për traktoristët. Me tmerr mendoi se ata mund të kishin vajtur në shtëpi për të fje-

tur. E ç'nuk i quajti gjatë asaj copë rruge që i kishte ngelur. Po s'la pa kritikuar edhe veten, që kishte qëndruar si buf përpara atyre dosa... dosjeve dhe nuk kishte shkuar atje për të ndjekur punët nga afër. Kishte përshtypjen se truri i ishte bërë me dhëmbë dhe po e hante të tën. Një gjarpër tjetër verbues u përplas fare afër tij, por këtë herë nuk qëndroi. Unë rri torturohem me net të tëra pa vajtur në shtëpi, kurse ju ia këputni gjumit për shtatë palë **qeje, arsyetonte** në tym, me logjikën e njëriut që mendon se vetëm ai ka sedër për punë. Vazhdonte të ecte si derr i plagosur, ndërsa sillte në mend, copa-copa, një grindje që kishte bërë me njërin nga traktoristët për punë pa cilësi. Dhe fajin ia hodhi atij. Tani ai ishte i aftë të gërryente çdo skutë të ndërgjegjes, ku mund të ishte struktur pak faj, ta nxirrte jash-të dhe të vërtetonte pafajësinë e vet, duke marrë për fakt ikjen e tyre në shtëpi në një kohë kur nuk duhej shkuar, si... ai. Si unë, tha me mend dhe u krekos pak, megjithëse ishte i bindur se nuk e shihte njeri. Po, po, tha me vete, ai i ka fajet, ai ua ka mbushur mendjen edhe të tjerëve për të lënë punën e për të shkuar te gratë. Po pse, more edepsëzër, unë nuk kam grua, nuk kam shtëpi, nuk kam fëmijë, si ju? Edepsëzër!

As vefë nuk e mori vesh se si iu afrua pasarelës. Të mos i shtyjmë ne për një punë, vazhdonte të arsyetonte turbull, këta nuk bëjnë asgjë. Pisat!

Hipi në pasarelë dhe mendja i tha të ecte me vrap, por diçka i kapi veshi, diçka si zhurmë metalike. Qëndroi sikur të kishte ngrirë befasisht. Zhurma u përsërit në zall të lumit, disa

metra mbi pasarelë. Vështroi andej dhe mezi mundi të dallonte një dritë të zbehtë. Dicka iu drodh në krahapor dhe kujtoi se iu shkërmiqën eshtrat. Sharje të tjera nxori nga mendja për traktoristët, por, për çudinë e tij, nuk pati guximin t'i pohonte. U kthye mbrapa dhe eci tatë-pjetë zallit. Nuk shihte fare se ku shkelte, por u lëshohej rrave e cermedelete me gjoks, hidhej nga një gur në tjetrin, duke u shtyrë vazhdimisht nga mendimet e një njeriu që është quajtur... tashmë, shpëtimtar. Po jetonte vetëm me sedrën e tij, me sedrën e tij të mirë, që luftonte me sedrën e keqe të të tjerëve.

Me ndjenjën e një zbuluesi të ndërgjegjes, të një njeriu praktik të pagabueshëm, u fut në lumë. Në kokë i gjëmonin goditje çekici, por ai pandehte se ato i kishte nga shqetësimi. Nga shqetësimi për... punën. Uji i arrinte në mes. Eci më tutje, duke i dhënë trupit pak pjerrësi për të zvogëluar sipërfajen e goditjes, por, ai, megjithëkëtë, i arriti në gjoks. Megjithëse në ujë të ftohtë, e ndiente trupin të nxehë. Vështroi përpara me sy të mjegulluar. Nuk pa asnje dritë. Mendoi se do ta kishin diktuar e, për t'iu fshehur, kishin fikur dritën. U mat përsëri të shante, por nuk mundi, sepse drita u shfaq përsëri dhe diku anash saj lëviznë hije. Të poshtë! shau me mend pas pak dhe i dha trupit përpara.

Iu afrua traktoristit të parë, duke iu shmanjur pak drejtimit të dritës.

— E?! — ia bëri kot, se në mend kishte rreshquar të tjera fjalë. Jo fjalë, por breshër. Ai ishte shndërruar në re të mbushur me kristale breshri.

Traktoristët ngrinë në vend. Po shihnin për-

para një njeri krejt të qullur, që ishte agronomi i sektorit, po nuk po merrnin vesh pse ishte lagur ashtu, kur mbi lumë kishte pasarelë. Ndërsa ai priste që t'i flisnin, ose më saktë, të shfajësoheshin për fajin që kishin bërë, për braktisjen e frontit të punës, për...

— Po ti?! — dëgjoi befas zërin e njërit prej traktoristëve dhe deshi me çdo kusht që ai të ishte zëri i atij traktoristit me të cilin ishte grindur pak ditë më parë për cilësinë e keqe të punës. Por u bind se nuk foli ai. Oh, q'do t'i ishte shkrehur atij, se gati ishte, ja, sa të luante pak këmbëzën e inatit dhe...

— Kot, ne e mbollëm! — dëgjoi pastaj një zë tjetër, të habitur, si zëri i parë.

— Si?! — ia bëri, ndërsa po i krijohej përshtypja se ishte në èndërr.

— E mbollëm!

Do të më jenë zënë veshët me ujë, mendoi dhe dëshiroi marrëzisht që të ishte ashtu. Si për t'u bindur për këtë, shkoi dorën mbi flokë. Dora nuk iu lag.

— Si?! — ia bëri përsëri. Veshët filluan t'i gjëmonin.

— E mbollëm, shoku agronom!

Uli kokën. Dëgjoi fare qartë, për këtë u bind plotësisht. Veshët nuk i gjëmonin më. Deshi të dallonte në fytyrat e tyre ndonjë shenjë që nuk e kuptonte plotësisht te zëri, por nuk mundi. Tek ajo që dëgjoi nuk kishte dyshim, por... diçka e brendshme, diçka që kishte filluar t'i thyhej, s'dihej që kur, e mundonte. Një mendje i thoshte të nisej e të kontrollonte në vend punën, por nuk vendoste. Ndërsa mendonte se vërtet ata e kishin mbjellë edhe atë grurë, mendonte njëkohësisht me turp edhe tërë ato

sharje që kishte nxjerrë nga mendja e vet pér ta. Shtoji pastaj edhe ndenjen në zyrë pér një kohë të gjatë pa bërë gjë.

— Nisemi pértej! — tha befas, sikur vëtëm pér të thënë atë fjalë kishte bërë tërë atë mundim. Pastaj u fut në ujë, duke u bërë shenjë atyre që ta ndiqnin pas me traktor.

— Ku të shkoj unë, do të shkelë traktori, — dhe mundohej t'i jepte trupit pjerrësinë e domosdoshme pér t'iu mbrojtur rrymës së rrëmbyster të ujit, duke përsëritur shpesh me mend: «Burrë i dobët!»

## S U M M A R Y

## Mirë

Gu-gu-gu, Marita, fshshsh...

Nuk kuptoj si ka hyrë në dhomën tonë gu-guftuja, Marita dhe gjarpri. Enden nëpër dhomë, përplasen nëpër mure, më ngacmojnë nëpër veshë. Gu-gu-gu, Marita, fshshsh... Nuk përmendem dot. Kam shumë nevojë pér gjumë. Kapakët e syve i kam të rëndë, si kapakët qivuri. Gu-gu, fshshsh, Marita. Ç'kérkon kjo guguftu në dhomën time?! Po Marita, ç'kérkon këtu?! Mos jam në èndërr? Ngre pak kapakët e syve. Në sy më hyn një rrisk drite. Nuk qenkam në èndërr. Kam shumë nevojë pér gjumë. Kapakët e syve duan të ulen. Filloj të përmendem disi. Kisha rënë pér të fjetur pas dyimbëdhjetës dhe në dhomë isha vetëm. Maqoja me Vurkon festonin datëlindjen e një shoku. Shoh orën, me gjithëse sytë i kam ende të mjegulluar dhe kapakët e tyre duan të ulen. Dua të përqendrohem pak. Në dhomë nuk ka guguftu. Ka Maqo, Vurko, Marita dhe gjarpër. Tani ëgjoj kthje-

llët. Maqoja bisedon me Vurkon. Herë me zë të qartë, herë me pëshpërima. Herë si guguftu, herë si gjarpër. Dua të thérres, t'u them të hesh-tin, se po më lënë pa gjumë. Ja, zëri i Maqos: «E pra, ajo Marita deshi të rrinte gjatë leksionit me mua atë ditë. Ulu, i thashë. Kur fësht, këmba e saj te këmbët e mia. E po, do t'i ketë shkuar padashur, mendova. Pas pak, frësht këmba e saj përséri te këmbët e mia. Kjo s'është rastësi, thashë dhe i propozova të venim në kinema në orën 20.00. Store. Pranoi. Kulmi ishte pas kinemasë. Më pëlqen shëtitja në këtë orë, më tha. Shëtitim, i thashë. Më tej po na vësh-tronte një polic. Me siguri po i lëshonte lëng goja, mendova. E kuptova që ajo donte të më mbetej në dorë.» Zëri i Vurkos: «E mban mend saktë kur ndodhi me ty kjo? Duhet ta kem pasur unë më parë se ti. Nejse. Mua m'u ngjit pasdite, gjatë studimit. Është një film i bukur sot, më tha, e shohim? Tani jam i zënë, i thashë, po de-she shkojmë më vonë. Pranoi. Shkova disa herë me të në kinema, natën. Le e le, po ky zambaku ynë ku i ka sytë që i është qepur si rrodhe?» Zëri i Maqos: «Do ta ketë për herë të parë që bie në femër. Mos është zgjuar e na dëgjon? Kot përmendëm emra. Flemë tani. Natën e mirë!» «Natën e mirë.»

Një mijë herë dëshiroja të isha në ëndërr. Një mijë herë i bëra pyetjen vetes: «Janë të vërteta, apo shpifje?»

Dasha ta harroja fare Maritën. Desha të bindja veten se për mua nuk kishte jetuar kurrë ndonjë vajzë me këtë emër, por nuk mundesha kurrsesi.

E tmerrshme! gati thérres me zë. Kthëhem në krahun tjetër. Dua të fle, por nuk fle dot. Në

dhomë hyn një zbardhëllim qumështor. Nëpër qytet dëgjohen zhurma makinash dhe në maloren përballë konviktit rrënkojnë urbanët.

Aha, lamtumirë, gjumë!

Rigon shi i hollë dhe i butë. Përmes rrjetës së tij duket sikur gjithçka sitet për të dalë më e bukur. Eci i përhumbur dhe dëshiroj që ai shi të mos pushojë kurrë. Të bjerë, të bjerë në fuqi *n*, siç thoshte një shoku im në kursin e matematikës. Dhe më hipën dëshira fë mos vete fare në leksion atë ditë. Megjithatë këmbët më çojnë drejt fakultetit dhe unë nuk i detyroj dot. të veprojnë ndryshe.

Në degët e zhveshura të drurëve kërcejnë zogj, duke shkundur poshtë pika të mëdha uji. Njëri prej tyre këndoi pak dhe unë u ngutë me mend të kujtoja llojin e tij. Nga kjo m'u kujtua fshati. Në fshat jeton nëna dhe mua m'u kujtua edhe ajo. Diçka m'u drodh brenda në gjoks. Në sill ca miell nga ai i Tiranës, më thoshte shpesh, se ai tëhollet dhe shkoqet më mirë. Sa herë vjetë në shtëpi, nëna bën lakror patjetër.

Befas ndiqë errësimin e qiellit mbi kokë dhe ndërprerjen e menjëherëshme të shiut. Pastaj përparrë më del një bisht çadre dhe dora që e mban atë.

— Mund t'ju shqetësoj, shoku romantik?

Marita Terati kishte dalë në krahun tim të majtë dhe buzëqeshte. Në qerpikë kishte bulëza të vogla uji, si ato bulëzat e vesës në muajt e verës. Zërin e kishte paksa të ngjirur dhe, ndoshta më shumë për këtë shkak, të jepte për-

shtypjen e një njeriu të singertë. E vështrova  
në fytyrë dhe në çast m'u përtéri fytyrë e nën-  
nës. Tani ke kohën t'i hedhësh kërrabën një-  
rës, më thoshte shpesh, sa herë shkoja në shtë-  
pi me pushime. Unë përsëri tundja vetëm kokën,  
si pa vetëdije. Apo e ke zënë dhe nuk më tre-  
gon mua? më pyeste pastaj dhe nëpër sy i val-  
lëzonte një shkëndijë e ndezur drite, mbetur  
atje ndoshta që nga rinia e saj. Ditën kur ni-  
ssesa për në shkollë, çdo herë e më shpesh më  
niste me vete më shumë copa lakrori, më shu-  
më arra dhe më shumë kokrra shegësh majhoshe.

Vështroja Maritën dhe kujtoja nënën. Nëna  
nuk do ta pranonte kurrë një nuse, në vajzërinë  
e së cilës janë hapur fjalë të këqija. Ajo nuk  
do të pranonte, gjithashtu, edhe të shoqërohesha  
me të. S'di pse e vështrova edhe një herë në  
fytyrë dhe më erdhi çudi kur kujtova se pikë-  
risht ajo vajzë, ajo Maritë, ishte aq e keqe. Dhe  
sepse fjala «e keqe» m'u duk shumë e rëndë  
për të. «Mund t'ju shqetësoj, shoku romantik?»  
solla ndër mend fjalët e saj. Dhe përsëri nuk i  
fola. Jo se Marita më quajti romantik. Ajo le  
të më quante edhe klasicist, po të donte, dhe  
unë përsëri nuk do t'i flisja, sepse do të duhej  
ta vështroja në sy dhe sytë e saj largonin, për  
mua, çdo keqkuptim.

Oh, sytë e saj mund të kuptohen vetëm po  
të jesh pranë syve të saj.

Ndërkaq kishim hyrë midis rreshtave të ta-  
volinave, nën peshën e një mozaiku vështrimesh.  
Ja, prisni, mos u bëni merak, se do t'i kuptioni  
sa të kota i keni dyshimet, mendova dhe u ula  
në tavolinën time. Por dola i gënjiyer nga ky  
mëndim, se, për çudinë time, pranë meje u ul  
edhe Marita. Atë çast në sallë hyri pedagogu

dhe unë nuk e quajta të arsyeshme ndonjë përpjekje për të kuptuar përsë ajo u ul pikërisht me mua.

I rënë në kurthin e mendimeve, gjatë orës së leksionit kujtova disa herë fshatin, nënën, duart e saj me brumë apo përparësen e pudrosur me pahun e miellit. Kujtova fjalët e saj për nusen dhe shtimin e racionit të gjërave që më niste me vete. Kujtova edhe fjalët që kisha dëgjuar për Maritën.

Vështroja andej. Marita shkruante. Krelat e flokëve ia mbulonin njërën faqe. Pse kështu?! pyeta kot veten, s'di pse. Ajo vazhdonte të shkruante. Ndieja mbi vete vështrime. Ti që dukesh si qengj.

Tingëlloi zilja. Trrr. Kështu bëri edhe zemra ime. Trrr. Sikur brenda saj të kishte bërë fole turtulli i shqetësimeve. U ngrita. U ngrit edhe Marita. Dhe vështrime mbi ne. Më shumë mbi mua. «Thëngjill i mbuluar!» Shpejtova hapat.

— Mirupafshim, Marita! — As vetë nuk e mora vesh se si më doli ky zë.

— Kur, Miço?

Zhurmë. Sytë e nënës. U mundova të qeshja pak, po nuk qesha dot. Asnjë vajzë deri atëherë nuk ma kishte bërë atë pyetje. Dhe në çast u dhashë hak Maqos e Vurkos. Para meje, ftyra e vrenjtur e nënës. Ja dhe ftyra e habitur e Maritës. Zogjtë e kujtimeve me lajme nga fshati: «E morët vesh? I biri i... merret me...»

— Kur t'i dalim njéri-tjetrit përpëra, Maritë, — thashë. Përsëri zhurmë. Hapa që largohen. Hapa që afrohen.

— Pse, nuk do të më ftosh në kinema? —  
Zëri i Maritës, pak i ngjirur, doli i zvargur dhe  
pak tallës.

Nuk po kuptoja asgjë. Në korridor një zë therriste: Marita! Marita!

— Pse?! — pyeta i habitur.

uirda önb ejn em

## Në një ditë shiu

Ka disa çaste që dera e sallës hapet dhe mbylljet duke lëshuar një zhurmë të lehtë, si ato që lëshojnë krimbat në dru. Orën e parë e kisha pushim dhe, si zakonisht, kur kam kohë të lirë, e shfrytëzoj duke lexuar.

— Ej koleg, vajti vonë. Mësuesi i mirë hyn në klasë pak para se të bjerë zilja!

Ngre kokën për të parë nga më erdhi ky zë. Ah, po, qenkësh mësuesi i matematikës. Nuk e kisha vënë re fare. Pak më parë ai dërgoi te mësuesja e ciklit të ulët, me anën e një nxënësi, nja katër litra qumësht për t'i zier. Në-për klasa e në sallë, për shkak të sobave, kri-johet pak nxehësi dhe ai nuk do që t'i prishen.

Ja, tani ai rri pranë sobës, duke u kujdesur për kërcinjtë e këmbëve dhe për këmbëzat e pantallonave. E lë një çast fare të shkurtër kë-të punë dhe hap mbi tavolinë disa copa lettrash. Pastaj, duke mos larguar vëmendjen edhe

ngaë këmbëzat e pantallonave, fillon të çukitë mbi fletë me një laps të kuq. Çuk-çuk. Herë-herë heq ndonjë vijë, herë bën ndonjë shenjë anash fletës. Duket se punon me ngut. Çuk-çuk. Duke besuar në fjalët e tij se vërtet jam vonë, ngrihem, marr regjistrin dhe nisem për të dalë nga salla.

— Meqë je në këmbë, futi dhe ca dru të tjera sobës!

Qëndroj në mes të sallës, kthej kokën nga kolegu dhe buzëqesh lehtë. Ai nuk e ngre fare kokën. Vazhdon të çukitë letrën me lapsin e kuq. Ndiej një si shtrëngim në gjoks, s'di pse, dhe befas diçka kujtoj.

Ej, Gent, afrohu këtu! E sheh atë sobën? Ashtu! Dua që ajo të bubullojë pas pesë minutash. Mirë? Si? Nuk ke shkarpa? Tani e prishë! Gjeji ku të duash shkarpat! Ja, sa të gjesh ato ti dhe sa të ndezësh zjarrin, unë korrigoj një pjesë të detyrave me shkrim që bëmë me ju. Po të mos kesh katranosur gjë, të mori dreqi! Hapt, fillo tani!

— Pushim këtë orë? — pyes.

Pres që ai të çojë kokën. Por ai nuk e con. Pasi e kupton (mendoj unë) se po pres përgjigje, thotë me zë pak të zvargur.

— Jam i zënë!

Pranë tij bubullin soba. Ai kalon lehtë një-rën dorë mbi këmbëzat e pantalonave. Nuk i them gjë tjetër dhe dal, duke tërhequr lehtë derën pas vetes.

Eci nëpër korridor me hap të shpejtë, i shoqëruar nga tingujt ngacmues të ziles. Në klasën ku do të bëj mësim, zhurma platitet menjëherë, sikur ta ketë përpirë dikush, duke lënë si jehonë fjalën «erdhi»!

Hedh regjistrin mbi tavolinën time dhe them:  
— Uluni!

Sajohet një zhurmë e lehtë, pas së cilës kujtoj se do të zotërojë heshtja, por ky është vetëm një iluzion. Jashtë bie shi tepër i rrëmbyer, që kërcet nëpër dritare me kërkellima të thata.

Largoj vëmendjen nga shiu dhe hap regjistrin.

— Kush mungon?

Pyetja ime mbetet pér një çast pa përgjigje. Nxënësja kujdestare është ngritur në këmbë dhe hesht. Qerpikët i dridhen lehtë, ndërsa sytë i vështrojnë pjerrtas. Në dritare shiu vazhdon të përplaset me forcë.

— Nuk ka mungesa? — Nxënësit lëvizin pak nëpër banka. Nxënësja kujdestare merr fryshtë thellë. Unë, ndërkaq, kam mbyllur stilografin dhe kam dalë para nxënësve.

— Mungon Artani, shoku mësues! — Zëri i nxënëses kujdestare del i dobët.

— Artani? Pse?

Nxënësit hutohen. Ulin sytë mbi librat e mbi fletoret e hapura mbi bankë. Në klasë zotëron prapë zhurma e shiut që përplaset në dritare.

— Është sëmurë? Flisni, pse mungon? — bëhem papritur nervoz. E ndiej që gaboj dhe mundohem të buzëqesh.

— Jo, mësues. Kishte harruar në shtëpi fletoren e detyrave të matematikës dhe mësuesi e dërgoi pér ta marrë. — Zëri i nxënëses kujdestare këtë herë del më i dobët. Nxënësit e tjerë vështrojnë nga dritarja. Xhamat e saj janë mjegulluar krejt dhe të krijojnë përshtypjen se matanë tyre fshihet misteri.

— E patë që u nis? — e ndiej dhe vetë që pyes fare kot, megjithatë nuk përbahem dot.

— Po, mësues!  
— Nëpër shi?! — ndiej ngjethje në trup.  
— Po, mësues! — Nxënësit fllasin gati njëherësh.

— A i dhatë ndonjë çadër? — Minutat ikin, ndërsa unë ende nuk po filloj mësimin.

Shkoj në dritare dhe pastroj me kujdes xhamat e veshur nga avulli. Vështroj larg, andej nga bën jetë rruga për në fshatin e Artanit, kujtoj këlegun që rri pranë sobës, duke u kujdesur pér këmbëzat e pantallonave, dhe bëhem tepër nervoz. Më hipën dëshira të rrëmbej një kovë me ujë dhe t'ia kërcej në trup, por befas përmëndem. I kthej kurrizin dritares dhe përpinqem të hetoj fytyrat e nxënësve. Po përsëri më shfaket kolegu, mësuesi i matematikës.

«Shoqja kolege, ju lutem, meqë keni shtëpinë këtu afër, më zieni pak qumështin. Klasat dhe salsa janë pak të ngrohta nga soba dhe kam frikë mos më prishet. Eh, të faleminderit! Vajza jote, mot vjen të ne, në mos gabofsha? — Këtu do ta merrni vazhdimisht qumështin? Po... pse të mos e marr vazhdimisht këtu? Kush ngrihet herët atje në qytet. Këtu merret fare lehtë. Duhet ta dish sejeta i jep njeriut aq sa ai di të marrë prej saj. Thuaji pak nxënës Lirimt të vijë këtu në pushimin e madh»...

Shiu bëhet më i egër përjashta. Kokrrat e tij u ngjajnë grushteve të vogla, që përplasen me forcë në xhamat e dritares. Kërkoj vëmenje nga nxënësit dhe dua të flas, t'u jap ushtrime, por kam përshtypjen se gjoksi më është ngushtuar dhe më pengohet frymëmarrja.

— Po trokasın në derë, mësues!

I bëj shenjë nxënësit që është më pranë derës për ta hapur. Dera hapet ngadalë dhe në

klasë hyn trupi i imët i Artanit që kullon ujë. Në dorë mban çadrën e kthyer në të kundërt edhe një fletore të mbështjellë me plastmasë. Duhet të bëj diçka, mendoj. Në qendrën e sektorit të kooperativës është furra për pjekjen e bukëve.

— Sokol, shqëroje Artanin deri te furra e bukës!

Vështroj për një çast nxënësit. Fytyrat e tyre zbulurohen nga një gëzim i lehtë. Rrëqethem papritur. Nxënës të urtë, të pastër, arsyetoj, buzëqeshin sepse nuk dinë ende të bërtasin.

Dua të zhvilloj mësim, por nuk mundem. Diçka tjetër shoh të arsyeshme të bëj. Kthehem vrulltas nga dera, e hap shpejt dhe dal në kordinor. Duhet ta kthej Artanin, arsyetoj, qoftë edhe një çast të shkurtër.

I hedh dorën në sup dhe hyj në sallë. Kolegu korregjon, bën shenja anës fletëve, fërkon kërcinjtë e këmbëve. Më hipën dëshira të bërtas, ta ngrë nga supet si leckë, ta pështyj. I afrohem tepër nervoz dhe bëhem gati t'i them me zë të lartë: «Çohu!», por nuk arrij, sepse tingëllon zilja. Tingëllon fort, me ngut. Shoh orën. Duhën edhe shumë minuta të mbarojë ora e mësimit, apo ora ime ka mbetur prapa? Apo drejtori ka parë gjithçka dhe... Sidoqoftë, unë do të bëj detyrën time...

## P E R M B A J T J A

NATA E BARDHË .....	3
DOBËSI .....	19
DUKE KERKUAR DERËN .....	30
LIGJERATË NGA MAJA E PEMËS .....	39
ZHGËNJIM .....	49
SHOQERORE .....	59
RADHA E BUKËS .....	73
SEDRA .....	81
MIRE .....	92
NE NJË DITE SHIU .....	98

Printed in 1900 by the Government of Albania  
ALBANIAN POLIGRAPHIC SOCIETY - TIRANA